




VKM: Fasonet nga sot automatikisht qira një euro

Favorizohen dhe investimet mbi 10 milionë euro

► FAQE 7



DOSSIER/ PEZË 1943

KAPITULLIMI I ITALISE, SI NISI LUFTA ME BALLIN KOMBETAR

► FAQE 16-17

[SHQIPTARJA.com]

LEKË 30

VITI IV - NR. 1 - 06-02-2014



ISH-BODIGARDI I AZEM HAJDARIT

MARJAN GRYKA “BERISHA E UDB VRASES, DESHMIA NE NJE KASETE”

Kreu i shoqatës “Hajdari”, azilant pas një atentati, flet për provën në duar të plakut të fisit të Haklajve, që është shumëfishuar dhe do të dalë në publik. Marrëdhëniet me Edi Ramën dhe shoqërimi që i bëri Gryka atij, si kryetar Bashkie, jashtë Tiranës

► FAQE 2-3



Satirë politike



NGA ARBEN DUKA

Policia ka arritur tek nota dhjetë...

► Në faqen 20

bashkë me rubrikën "VIP-a dhe Firipa"

Koment



NGA ARJAN BREGU*

Kanceri, të rrëzojmë mitet

Dita Botërore e Kancerit, 4 shkurti, është e vetmja iniciativë ku e gjithë bota mund të bashkohet në luftën kundër epidemisë globale të kancerit...

vijon në faqen 13

● INTERVISTA

Edi Rama: Ju tregoj telefonatën me të cilën u bëra ministër

“Babai ishte komunist, unë antikomunist, bënim sherr”



Fatos Nano dhe Edi Rama

HANS ULRICH OBRIST
NEW YORK

E dhe në epokën tonë, kur na duhet të bëjmë një-kohësisht një pafundësi punësh të ndryshme, pak artistë janë bërë liderë botërorë dhe pak liderë botërorë artistë. Por, kryeministri Edi Rama i Shqipërisë...

► FAQE 8

BANDA E TRITOLIT

Gruaja e killerit, drejtuese në institucionet e Shëndetësisë

► FAQE 12

PIKTURA E KOSOVES

Hashim Thaçi falenderon Edi Ramën



► FAQE 18

AKSIONI KUNDËR NDËRTIMEVE PA LEJE

Shembet me tritol pallati 7-katësh në kryeqytet

► FAQE 10

Shurupë për kokteile dhe likerëra për bare dhe restorante

Adresa: Autostreda Tiranë- Durrës, km 7, Yrshk Tiranë; Tel: 042 406 500; 042 406 501; Fax 042 406 502; e-mail: neranxi@neranxi.com; www.neranxi.com

» INTERVISTA

ISH-TRUPROJA e Liderit të Dhjetorit tregon skemën e mënjanimet dhe eliminimit nga kupola e PD. Ai s'beson se kjo drejtësi zbardh vrasjen e tij por kërkon rihapjen e çështjes

Gryka: Sali Berisha agjent i UDB, ai evrau Azem Hajdarin

"Tregoj skenarin e aktorët e vrasjes. Ndiqej nga Gazidede"

JAKIN MARENA
TIRANE

Marjan Gryka, ish-truproja e Azem Hajdarit, president i shoqatës "Hajdari" në një intervistë për gazetën "Shqiptarja.com" flet për skenarin e vrasjes së liderit të Dhjetorit, duke akuzuar Berishën si aktor kryesor si dhe kërkon rihapjen e çështjes. Ai flet për marrëdhëniet e tij me Ramën, si dhe kthimin e shoqatës në parti.

Ju keni qenë bashkëpuntori më i afërt i Azem Hajdarit. Çila ka qënë rruga juaj gjatë kësaj periudhe....?

Për afro 10 vite kam punuar dhe jetuar me Azem Hajdarin. Kam qenë i besuari dhe bashkëpunëtor i ngushtë i tij, në gjithë këto vite të cilat kanë qënë shumë të vështira, me përplasje, me tradhti, me plumba e me skenare të brendshme. Që do të thotë se ne ishim gjithmonë në betejë, duke luftuar për Demokracinë, por kjo e çenonte jetën tonë çdo ditë, sepse për figurat e PD, Liria dhe Demokracia ishin kthyer në një interes ekonomik në të gjitha drejtimet, dhe kështu ne çenoni llogaritë bankare të tyre!

Berisha dhe Hajdarin kanë pasur përplasje të forta. Cilat kanë qënë prapaskenat e përplasjeve mes tyre në vitet 90-të?

Berisha dhe Hajdari kanë pasur përplasje të forta, sepse Azemi e njohu Berishën shumë shpejt, bashke me skenarin e tij ramizjan! Sot koha e tregoi se Azemi kishte pasur të drejtë që luftoi kundër klanit të Ramizit. Unë po kujtoj këtu disa nga këto! Kur Berisha ishte President nga kupola e kësaj ndërtesë drejtohe çdo gjë dhe gjithçka edhe në parti. Për çdo gjë ishte i qetë, sepse populli demokrat kishte votuar komunistin më të pabesë të gjithë kohrave dhe armikun e demokracisë! Me përjashtim të njërit që ishte Azem Hajdari dhe përplasjet e tij me Kryeministrin Meksi kishin filluar, sepse Meksi zbatonte ato që Saliu urdhëronte. Po ashtu edhe kreu i PDSH, pasi Tritan Shehu urdhëronte çdo ditë krerët e degëve të PD në rrethe që Azemi të mos pritej askund sepse e ka futur Sigurimi i Shtetit të shkatërrtoj PD-në! Pra kjo ishte treshja mjerane që e kishte shpallur

Akuzat
"Dy emisarët e Ramizit ishin aktorët dhe organizatorët e vrasjes së shekullit, Fatos Nano Kryeminister dhe rivali i Azemit, Sali Berisha shefi opozitës".

Azemin armik, dhe në një mbledhje këkë më kokë Saliu i tha 'Leninit të Verdhtë' Pollo se Azemi po na del jashtë kontrollit, prandaj duhet të jemi të kujdesshëm! Pra e gjithë PD që Azemi themeloi u vërsul kundër për ta shkatërruar në çdo drejtim, por lind pyetja a mund të rrezohet kollaj një mal? Azemi si një burrë i rrallë vendosi të përballë dhe me kolegët e Ramizit siç u përball me shefin e tyre dhe ashtu u bë: Betejë në rrugë, me atentatet të organizuara nga vetë këta që sapo përmenda, betejë në Parlament, në selinë e PD.

Berisha erdhi si i dërguari i Ramiz Alisë në lëvizjen studentore. Si mundi ai të fitojë aq shumë pushtet në atë kohë sa të flakte dhe Azem Hajdarin, ta linte jashtë strukturave deri në vitin '97?

Berisha erdhi në krye të PD, jo vetëm i fortë i stërvitur nga vetë Ramiz Alia deri me fonde financiare marramendëse, por ai kishte vite që punonte për sigurimin e huaj dhe skenarin për gropsjen e partisë së parë pluraliste në vend që kishte me dy vula, si për Shqipëri-në ashtu dhe për Kosovën! Por dhe pse kaq i pushtetshëm, ai përseri friksohej nga Azemi dhe kjo frikë e bënte të organizonte puçe nga më të ndryshmet e të ultat ndaj tij. Dhe duke qenë i pushtuar nga kjo frikë, ai u detyrua ta zgjerojë skenarin me shiroksin tonë të Shkodrës, Pjetër Arbnorin, Mandelën e Parlamentit e jo të Popullit dhe ky i fundit bën propozimin për heqjen e mandatit të deputetit Azem Hajdari, si një figurë që ka devijuar vijën e partisë. Atë ditë SHIK i Gazidedes ishte i tëri në Kuvend, por edhe Garda e Halit Gjeçit! Pra kaq frikë e kishin Azemin këta mjeranë të komunizmit e kjo ndodhte, sepse ata kishin pushtetin por Azemi kishte me vete popullin. Atë ditë kur u bë ky propozim pas ca minutash Azemi mori fjalën, megjithëse s'donin t'ia jepnin! Ndër të tjera iu tha: "Sa merreni me kontrollat ordinere kundër meje se ku i marr makinat, se ku i hedh karburant se ku ha dreka, ju ftoj të keni në mbikqyrje hotelet ku shumica e grave të tua po u frekuentojnë, duke harruar familjet e tyre, se burrat i kanë harruar me kohë. Unë nuk e kam të pamundur t'i filmoj e të mi sjellin në kamera që t'ju publikoj dhe të shikojë ky popull se çfarë bëhet me ata që tregojnë moral por nuk kanë aspak të iltillë vetë. Por nuk dua të bëhem si ju sepse as nuk isha e as nuk jam si ju e as nuk do bëhem kurrë, sepse ju jeni zotuar të shkatërroni Azem Hajdarin, por po e arritë t'ju shkatërroni

Berisha

"Berisha erdhi në krye të PD, jo vetëm i fortë i stërvitur nga vetë Ramiz Alia deri me fonde financiare marramendëse, por ai kishte vite që punonte për sigurimin e huaj".

demokracinë dhe PD-në e jo vetëm mua. Ju doni të më lini pa mandat që të jem pa imunitet dhe dikush mund të shkrepë plumba kundër meje. Ky është kërcënimin direkt dhe ky është skenari juaj kryesor, që frika të më mbyllë gojën! Por gaboheni rëndë mor të mjerë, sepse jo vetëm që do flas me zë më të lartë, por ata që keni frike jeni ju dhe jo unë, ata që dun Azemin e vrasë jeni ju që nuk flini, sepse sot Azemi do ishte më i miri për ju, po të rrinte të vidhte si ju dhe ta përdorte votën e popullit për xhepat familjarë. Unë i kam treguar shqiptarëve që babaim ka qenë komunist, por që idealat e tij unë i rrezova në '90-tën, por nuk mund të rri sot këtu pa thënë se më vjen keq për nënkryetarin e PD, Pollo që si djali i një ish-oficeri grek po vazhdon rrugën e babait të tij, duke bashkëpunuar me kryeministrin tonë Meksi djalin e ish generalit grek! Unë nuk mund të hesht për Gazideden që e kam pas kudo, se ti s'je SHIK i Shqipërisë por i Serbisë dhe është turp që presidenti Berisha ka lejuar SHIK që sot të mbushë sallën e Parlamentit! Une s'mund të hesht për të deklaruar se s'mund të vritem! Ju dhe mund t'ia arini qëllimit, por unë hesht vetëm kur të vdes! Kjo sallë e mbushur me agentura të huaja më jep kurajo të mëtejshme të luftoj sepse e shikoj

KASETA TE HAKLAJT

"Plaku i Haklajve një burrë i nderuar me pamje fisnike na ka takuar dhe kur është ndarë nga ne, Azemi i ka dhënë një kasetë por tani ajo kasetë është shumëfishuar e do i vijë dita të dalë!"

live kundërshtarin çdo ditë, por me petkun demokrat.

Rikthimi i Azem Hajdarit në PD u bë me dëshirën e tij, apo pas këmbënguljes së Berishës, që ishte në kuotat më të ulta politike?

Më '97 Azemi nuk u rikthye në PD, sepse ai nuk kishte ikur kurrë nga ajo parti, por e kishin përjashtuar kupola vrasare e partisë, dhe Berisha në vitin e egër '97 futi sekretaren e tij të na telefononte për ta përkrahur. Azemi nuk u kthye te Berisha por te e djathta e tradhëtar nga Berisha, Azemi nuk u kthye për të penguar rrezimin e Berishës, sepse Berishën e rrezoi Zoti e jo e Majta, por u kthye se 200 telefonata në ditë i vinin nga e gjithë Shqipëria ku i thonin se Saliu na mori më qafë! Për Azemin ishte e rëndësishme sakrificat për vendin e për të djathtën, sepse përta i përket '97 në krye të bandave ishin përsëri kolegët e Saliut, Gjinushi, Ceka, Nano, etj. Pra Saliu nuk po rrezohet por po groposej e Djathta me qëllim prej tij!

Azemi Hajdari ka pësuar shumë atentate. Sipas jush kishin një prapvijë politike këto atentate dhe kush i organizonte ato, pasi ishin atentat e para politike?

Në lidhje me atentatet që janë bërë



Sali Berisha dhe Azem Hajdari

kundër Azemit, por edhe sot kundër meje duhet të keni parasysh se sado që politika është munduar t'i përdorë, t'i ripërdorë herë për t'i errësuar e herë për t'i përdorur, nuk ia ka arritur dot sepse tani dihet nga mbarë populli se Azemin e vrau kompromisi PD dhe PS. Pra dy emisarët e Ramizit ishin aktorët dhe organizatorët e vrasjes së shekullit, Fatos Nano Kryeminister dhe rivali i Azemit, Sali Berisha shefi opozitës. Pra skenari Katovica realizo 100% dokumentin Alia më '98 me pushtatimin e liderit të Dhjetorit Azem Hajdari, dhe në këtë rrjedhje jo vetëm i janë drejtuar pyetje

me fakte deri në akuzë Berishës por edhe Nanos, të cilët sot janë përsëri bashkëpunëtorë e miq të deklaruar! Por vetë drejtësia ka qenë dhe është vegël e politikës. Dua t'ju kujtoj këtu se Pandeli Majko si Kryeministër ka akuzuar Berishën për vrasjen e Azemit por dhe ka kritikuar drejtësinë! Vetë ish kryeministri Ilir Meta bërë

titi me zë të lartë: Të arrestohen vrasësit e vrasësve të Azem Hajdarit! Pra dinte shumë ky kryeministër! Gramoz Ruçi ka akuzuar disa herë Berishën për vrasjen e Azemit në Parlament! Erion Braçe e shumë deputetë të tjerë e kanë bërë këtë, por këto ishin dhe janë vetëm shashka të të dy partive bashkëpunëtoresh me njëra tjetrën dhe shou mediatik për popullin, sepse një gjë dihej: Vetëm vrasja e Azemit e ringjallte komunizmin në Shqipëri!

Kanë lidhje këto atentate me akuzat që janë bërë vazhdimisht, madje me ato 25 pyetje e famshme në një gazetë afër Berishës?

Sot kur flasim për Berishën dhe PD, ka një ndryshim thelbësor, sepse une e mijra të tjerë jemi të djathtët e Partisë Demokratike që themeloi Azem Hajdari. Ndërsa Berisha i përket PD të krijuar nga Lulzim Basha, një person me probleme të mëdha me Drejtësinë, person që ka pasur lidhje pune me vajzën e Berishës e Berishën por kurrë me PD e të djathtën, një djalë komunist që bën të njëjtën detyrë si baballarët e tij bashke me Sali "Pencilinën"! Sot jemi më të bashkuar se kurrë jo te veteranët e shkollës së Bashkuar të Nishanit e as te veteranët e Saliut, por tek Partia e viteve '90 ku është dhe memoriali i Azemit që tmerronte çdo ditë Berishën poshtë zyrave të tij! Sot



Agjuntura

“Bankat janë plot me lekët e politikanëve të vjedhura ndaj popullit. Po që se do ketë Ukrainë kjo nuk është e Saliut se Saliu ka qënë oficer i UDB-së e jo boksier!”

Për Majkon

“Vetë drejtësia ka qënë dhe është vegël e politikës. Dua t’ju kujtoj këtu se Pandeli Majko si Kryeministër ka akuzuar Berishën për vrasjen e Azemit por dhe ka kritikuar drejtësinë”.



Ish-truproja: Si e shoqërova Ramën në të gjithë Shqipërinë

Gryka: Kryeministri të rihapë çështjen e Hajdarit, të çojë para drejtësisë vrasësit e 21 janarit e “Gërdecit”

kemi në krye të vullës një KOP i ardhur pas detyrës si hetues e spiun i UÇK, sot kemi një parti familjare ku atë post e donte me çdo kusht Luli për t’i ikur akuzave të bëra ndaj tij, ku sot mban bashkinë me votat e keqpërdorura të demokratëve. Ai i mori këto poste sepse firmosi që do zbatonte të gjitha çfarë mafia politike i kërkon, dhe kjo doli hapur në dritë të diellit me vrasjen e Sokol Olldashit ku e qindra pista vrasjesh dolën, me qindra skenarë e gënjeshtira si e si për ta mbuluar këtë vrasje të radhës në PD, por këtë radhë me aktorë të rinj! Olldash i kishte deklaruar projektet e tija dhe rrugën që do të ndiqte për një PD tjetër, por edhe kishte shfaqur hapur kundërshtimin e tij ndaj Lulzim Bashës dhe kjo e vrau. Pra edhe një figurë tjetër në PD u vra! Sepse për 20 vite ky ka qënë zbatimi i Katovicës, kush kundërshton vritet. Po kjo vrasje ka edhe bashkëpunimin e vetes që kanë pasur vrasjet e tjera, sepse në vendngjarje shkuan forcat e policisë, që fshehën çdo provë dhe shkatërruan skenën e krimiit dhe kur Olldashi u zhvarros doli se aksidenti i kishte kishte ardhur dhe e kishte qëlluar në kokë me sende të forta! Dhe Trebicka i dytë u realizua për mafien politike!



Për Ramën

“Jam në përgatitje e sipër të një artikulli të gjatë për lidhjet e mijja me Edi Ramën kur ishte vetëm kryetar bashkie dhe unë mora përsipër ta dërgoj në takime në të gjitha rrethet e Shqipërisë”.

Mendoni se nuk do zbardhet asnjë prej këtyre ngjarjeve...?

S’kemi as të akuzuar as të arrestuar, por vetem shou mediatik të PS e PD. Ashtu siç po e vazhdojnë për vrasjet e 21 Janarit, të premtuar nga Rama, ku vetëm vazhdojnë të akuzojnë e asgjë tjetër s’bëhet. Është e turpshme për këtë qeveri që vijon të luajë sikur është akoma në opozitë e nuk zbardh as 21 Janarin, kur BE e SHBA ia kanë vënë kusht themelor, nuk zbardh ngjarjet në Gërdec me Medium, Shkelzenin, Deljorgjin! Ku s’zbardh vrasjen e deputetit të saj Fatmir Xhindi, ku vetë ky ministër Rendi ka akuzuar Agron Kuliqin për këtë e për Trebickën! S’mund të ecet me parime, por me vepra që deri tani s’ka asnjë, kemi thjesht vetëm zëvendësime militantësh. Që Rama nuk ka këllëq të arrestojë Saliun ku nuk do shumë mend, që Ramën e ka akuzuar Meta kjo nuk do shumë mend, por pse gabon Rama nuk kanë pse shqiptarët të vuajnë përsëri gënjeshtirat e tritoleve dhe arrestime sekserësh, kur bankat janë plot me lekët e politikanëve të vjedhura ndaj

popullit. Po që se do ketë Ukrainë kjo nuk është e Saliut se Saliu ka qënë oficer i UDB-së e jo boksier!!

Plaku i Haklajve ka thënë se ka një kasetë të Hajdarit, ku thoshte që të gjitha vrasjet vijnë nga zyra matanë(e Berishës) e se nuk kishte lidhje me vrasjen e djemve të tij. Komentit juaj?

Plaku i Haklajve një burrë i nderuar me pamje fisnike na ka takuar dhe kur është ndarë nga ne, Azemi i ka dhënë një kasetë por tani ajo kasetë është shumëfishuar e do i vijë dita të dalë! Pasi politika nuk e la drejtësinë ta sillte Saliun në gjyq, që plaku i Haklajve t’ia përplaste në fytyrë ato çfarë i kishte thënë Azemi atij, për 25 vite shqiptarët shohin vetëm vrasje e asgjë tjetër. No koment!

Sa besim keni te drejtësia për zbardhjen e vrasjes së Hajdarit?

Shoqata Azem Hajdari që përfaqësoj, si President i Përgjithshëm i saj, i ka dërguar kërkesë ish-kryeprokurores Ina Rama, “Silvia Konti”, kërkesë për rihapjen e çështjes Hajdari, por s’ka asnjë muaj që ia ka dërguar dhe Kryeprokurorit Adriatik Llalla për ta rihapur këtë çështje jo si obligim por si detyrim nder në detyrën që ai pëfaqëson dhe të thërrasë si të pandehur Sali Berishën, pasi është dëshmitari kryesor publikisht për vrasjen e Azem Hajdarit, ku jo vetem i ka deklaruar me emra ato, por ai ka kasetën e incizuar nga Zenel Neza ku mori 6 plumba në atentat ku vetë Berisha i ka dërguar një faks zyrsë së OSBE para vrasjes!! Pas këtyrë vijnë dhe të vërtetat e Izet Haxhixhi, truprojes së Berishës vjen dhe kasete e Haklajve vjen dhe Fatmir Meta, por dhe Fatos Klosi ku vete Berisha e quan organizator në vrasje, ndërsa vetë Klosi e ka deklaruar implikimin e Berishës në vrasje. Jo se ne nuk e kuptojmë heshhtjen e zotit Prokuror ndaj nesh siç kuptuam “Silvian” e politikës, por këta mos të harrojnë kurrë se janë direkt përgjegjës për implikimin e institucionit me politikën duke penguar të vërtetën. Jo gjithmonë kjo mafie politike do mundet të vrasë e të grabisë popullin. Askush në botë nuk do na ndale që busti i Azem Hajdarit të vendoset aty ku ishte busti i diktatorit Hoxha, askush nuk mund të na ndalë të jemi në selinë e Partisë tonë të vërtetë, nuk do mundet



Marjan Gryka me Ridvan Boden, familjen Hajdari dhe anëtarët e shoqatës

kurrë Saliu me suiten e tij të mbulojë të tija me një bust të turpshëm që i bëri Azemit që në pamje duket si Balboa e jo si Azem Hajdari, Saliu e di mirë se Shoqata ‘Azem Hajdari’, e deklaruar armike nga vetë ai, do shpallet Parti politike ku do jetë vlera e lufta e Azemit për Demokraci e për të drejtën dhe jetën e popullit. Plumbat që i dhatë Azemit nuk na trembën, por na dhanë forcë në rrugën tonë.

Kjo do të thotë që nuk keni besim...?

Përsëris, plumbat që më dhatë mua me skenar të Dezinjatores Topalli nuk më zbehën, por më forcuam më shumë në rrugën tonë të pandalshme. Deklarojmë se, po që se po vjen një Ukrainë s’vjen e nuk e bën dot Saliu me familjen, por po vjen nga vrasjet dhe padrejtësitë që i keni bërë popullit! I themi kryeministrit që me turp po i kërkon ndihmë gjithë botës për

ruan vetëm parti dhe sot janë trafikantë të krahut tjetër!

Ç’kërkoni nga kryeministri Edi Rama, që ka qënë dhe dhjetorist?

I rithemi sot kryeministrit Rama largo ata që dëmtojnë Drejtësinë e mos bjer pre e presionit të tyre, dil e deklaro me kërkesë për rihapjen e çështjes Hajdari si një nismëtar i lëvizjes studentore të ‘90-tës e si pedagog i asaj kohe për të zbardhur shumë dyshime e enigma ndaj kolegëve të tu brenda partisë e për të mos kopjuar dhe qeverisur si Sali Berisha, por të realizosh premtimet e bëra në fushatë dhe për t’ju drejtuar organit të akuzës për ato çfarë akuzoje Saliun, kur ishe në opozitë. Në të kundërt nuk ka vetëm Ukrainë por ka dhe Egjipt. Unë si Marjan Gryka jam në përgatitje e sipër të një artikulli të gjatë përlidhjet e mijja me Edi Ramën kur ishte vetëm kryetar bashkie dhe unë mora përsipër ta dërgoj në takime në të gjitha rrethet e Shqipërisë, sepse vetë Rama nuk kishte dalë në jetën e tij në asnjë takim jashtë Tiranë, por dhe se kërcënimet e Nanos e të Saliut e ndiqnin kudo dhe i bllokoni rrugët. Por ne arritëm ta dërgojmë në të gjithë Shqipërinë në takime të sukseshme, dhe kur mbërrija në darkë në shtëpi i

Presionet

“Kur mbërrija në darkë në shtëpi i gjeja në radhë sekserët e Nanos e të Saliut, me shumta të mëdha parash për ta shitur Ramën e për ta lënë në rrugë”.

APEL KRYEMINISTRIT

“Kryeministër, të realizosh premtimet e bëra në fushatë dhe për t’ju drejtuar organit të akuzës për ato çfarë akuzoje Saliun, kur ishe në opozitë”

Lazaratin se llogaritë i ke bërë gabim me këtë fshat që e publikon si Çeçeninë! Eja se të çojmë ne t’i takosh dhe të bisdoshe me ta siç çam Moisiun, Blushin, dhe Makbulen, po që se të ka lidhur frika si për 21 Janarin e Metës, atëherë po të themi se me forcë je i humbur! Lazarati është pjesë e Shqipërisë e jo letra bixhozi të politikës. Sekserët ndër-

gjeja në radhë sekserët e Nanos e të Saliut, me shumta të mëdha parash për ta shitur Ramën e për ta lënë në rrugë sepse rrëzimin e Nanos po e realizojmë. Shumë nga këta individë deputetë sot janë në krah të Rames dhe bëjnë të përvëluarin ndaj tij, do paraqes kasete dhe foto që nuk janë publikuar asnjëherë më parë.

Kushtetuesja: Qeveria të mos ndërhyjë në kompetencat e Kuvendit


Vendimi i gjykatës, ja pasojat për nëpunësit civil

Sokol Hazizaj: Anulothen emërimet kundër ligjit

ARTEMISA HOXHA
TIRANE

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për rrëzimin e Aktit Normativ të qeverisë për Nëpunësin Civil pritet që të ketë pasojat e tij mbi të punësuarit në administratë pas hyrjes në fuqi. Për këto pasoja, në një prononcim të gjatë për gazetën Shqiptarja.com, juristi dhe ish-ministri i Drejtësisë, Sokol Hazizaj argumenton tre momentet kyç që sjell ky vendim si dhe arsyen e paligjshmërisë që del tashmë për nëpunësit që janë punësuar në periudhën e miratimit të aktit të Kuvendit deri të marrja e vendimit nga Kushtetuesja. "Momenti i parë varet nga fakti që a është shprehur Gjykata Kushtetuese për hyrjen në fuqi? Gjykata Kushtetuese duhet të shprehëse që do të bëjë me periudhën e hyrjes në fuqi të vendimit. Së dyti, sa kohë që vendimi i Gjykatës Kushtetuese hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare atëherë i gjithë problemi është se çdo të bëhet me periudhën nga hyrja e në fuqi e ligjit deri në hyrje në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Afati
Sa kohë që vendimi i Kushtetueses hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare atëherë i gjithë problemi është se çdo të bëhet me periudhën nga hyrja e në fuqi e ligjit deri në hyrje në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.



Sokol Hazizaj

kritereve kushtetuese të nevojës dhe urgjencës, të përcaktuara në nenin 101, si dhe të konsensusit politik të arritur në Kuvend në maj 2013. Vendimi i zbardhur përbëhet nga 41 faqe, ku 5 gjyqtarë kanë votuar pro rrëzimit të aktit pasi cënon parimin

e ndarjes dhe balancimit midis pushteteve, në dërrasa 4 gjyqtarë kanë dhënë votën pro variantit të qeverisë Rama. Mes tyre ka qenë edhe kryetari i Gjykatës Kushtetuese Bashkim Dedja, i cili në dhjetorin e kaluar u rikonfirmua nga Parlamenti në

krye të kësaj gjykate. "Kuvendi, në referim të Kushtetutës dhe jurisprudencës kushtetuese, nuk ka përmbyshur detyrimet kushtetuese që kanë të bëjnë me vlerësimin në formë dhe në përmbajtje të aktit normativ, duke e miratuar atë në kundër-

shtim me nenet 7 dhe 101 të Kushtetutës. Kërkuasi argumenton se, në referim të nenit 81 të Kushtetutës, ligji për statusin e funksionarëve publikë miratohet me tri të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Nisur nga një interpretim sistematik i Kushtetutës, konstatohet se kushtetutëbërësi i ka përjashtuar ligjet që parashikohen në 81 i Kushtetutës nga fusha e veprimit të nenit 101", thuhet në pretendimet e palëve.

VENDIMI

Halimi: Çdo lëvizje në administratë është nul



— Rrëzimi i Aktit Normativ të qeverisë nga Gjykata Kushtetuese u cilësua nga deputeti i PD-së, Eduard Halimi, si fjalë e drejtësisë. Në një postim në faqen e tij në "Facebook", Halimi shkruan se çdo vendim që është marrë për shkarkimin e punonjësve nga puna me ligjin e vjetër të shërbimit civil është i pavlefshëm. "Çdo akt i kryer mbas datës 1 tetor për largimet dhe emërimet që është mështetur në ligjin e vjetër është nul, absolutisht i pavlefshëm. Vendimi i sotëm i Gjykatës Kushtetuese është një vendim i drejtësisë, që respektim para së gjithash dhe mbi të gjitha sovranin, qytetarët dhe si i tillë duhet respektuar", shkruan Halimi.

Çlirimi



70 vjetori i çlirimit, Meta takon veteranët e luftës

Komision të posaçëm për organizimin e festimeve

Lëvizja Socialiste për integrim duet se po tregohet shumë e kundërshtueshme për festën e 70 vjetorit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, e cila për këtë ka paraqitur edhe një kërkesë për ngritjen e një komisioni të posaçëm për organizimin e kësaj feste. Në kuadër të kësaj, kryetari i Kuvendit Ilir Meta, zhvilloi një takim në zyrat e Komitetit të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ku biseda u fokusua për projektin e krijimit të një komisioni ndërshtetëror për festimin e 70 vjetorit të çlirimit të vendit. Z. Meta shprehu gjithë vullnetin e tij për të bërë gjithçka për nderimin në mënyrën më të mirë të mundshme të këtij momenti të një rëndësie të veçantë historike. "Respekti i sakrificave të pashembullta të popullit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore, rivlerësimi i saj i drejtë dhe historik edhe në emër të unitetit kombëtar, është një detyrë e të gjithëve".

Vlerësimi
Respekti i sakrificave të pashembullta të popullit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore, rivlerësimi i saj i drejtë dhe historik edhe në emër të unitetit kombëtar, është një detyrë e të gjithëve



të çlirimit dhe kërkoi bashkëpunimin e Komitetit në këtë drejtim. Ndërkohë që gjatë fjalës së tij, kryetari i Komitetit të Veteranëve, Kustem Peçi falënderoi për vëmendjen e vazhdueshme të Kryetarit të Kuvendit dhe njëherësh kreut të LSI vizitën e tij në selinë e tyre. Ai tha se shpesh punët dhe veprimet e mira e të duhura bëhen pa bujë, por me vullnet të

Kërkesa
LSI ka paraqitur edhe një kërkesë për ngritjen e një komisioni të posaçëm për organizimin e festës së 70 vjetorit të çlirimit të vendit.

ndershëm. Peçi vlerësoi vëmendjen e kryeparlamentarit për problematikën e diskutuar dhe garantoj, në emër të Komitetit të Veteranëve, bashkëpunimin e tyre në projektin për festimet e 70 vjetorit të çlirimit. "Nuk ishte takimi ynë i parë dhe natyrisht nuk do të jetë as i fundit. Je gjithmonë i mirëerdhshur mes nesh", tha zoti Peçi. Kryetari i Kuvendit shoqërohej në këtë vizitë edhe nga deputeti i Kuvendit, Luan Rama. Ishte vetë deputeti Rama, i cili bëri publike edhe kërkesën për ngritjen e komisionit. "Viti 2014 është viti i 70 vjetorit të çlirimit të atdheut. Kjo ngjarje e madhe, bashkë me shpalljen e Pavarësisë meriton vëmendje të posaçme dhe respekt të veçantë, nderim të madh nga e gjithë shoqëria shqiptare. Është detyrë e qeverisë dhe në emër të LSI i propozoj të krijoj një komision të posaçëm shtetëror gjithëpërfshirës me qëllim që programin dhe festimin i 70 vjetorit të jetë i denjë për këtë ngjarje të madhe të nderojë sakrificën sublime dhe gjakun e dëshmorëve. Është e pafalshme të anashkalohen ngjarjet të tilla që kanë shënuar dhe bërë epokë", ka thënë Rama.

ARSYETIMI LIGJOR
Në vendimin e saj, Kushtetuesja thekson se Akti Normativ është miratuar në shkeljetë parimeve kushtetuese, konkretisht parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, të

Greqi

JAKIN MARENA
ATHINE

Bushati-Papulias: Gati të bisedojmë për çështjet e pazgjidhura

Ministri i Jashtëm në Athinë, takime dhe me Samaras, Venizelos dhe homologët e rajonit

Shefi i diplomacisë shqiptare do të shfrytëzojë takimin e Athinës për të biseduar dhe kontribuar në zgjidhjen e të gjitha çështjeve të mbetura pezull mes Greqisë e vedit tonë. "Shqipëria, e gatshme për të biseduar për çështjet e pazgjidhura konkrete për çështjet e pa adresuara me Greqinë", ka qënë deklarata që është bërë nga ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Ditmir Bushati gjatë një takimi të veçantë me Presidentin e Greqisë, Karolos Papulias, në kuadër të vizitës që po zhvillon në Athinë. Bushati kërkoi që, si vende anëtare të NATO-s, të trajtohen çështjet e mbartura në përputhje me realitetin e ri në rajon, në kuadër të fqinjësisë së mirë dhe përkatësisë evropiane të të dy vendeve tona. "Ne jemi të gatshëm të bisedojmë për çështjet e zgjidhjeve konkrete për çështjet e pa adresuara, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve e janë me interes të ndërsjellë për dy vendet tona", u shpreh ministri. Duke theksuar vëmendjen e posaçme që qeveria e Shqipërisë i kushton marrëdhënieve të gjithanshme me Greqinë, Bushati i ka nën-

vizuar vlerësimin se Greqia ka qënë dhe mbetet partner strategjik i Shqipërisë. Ai u shpreh besimplotë në progresin e marrëdhënieve shqiptaro-greke, në interes të dy vendeve dhe popujve tanë, të paqes, sigurisë dhe zhvillimit të të gjithë rajonit. Bushati vlerësoi rolin dhe kontributin e çmuar të Presidentit Papulias në zhvillimin e marrëdhënieve miqësore dhe të fqinjësisë së mirë mes dy vendeve, jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës së Presidentit të Republikës së Greqisë, por në vijimësi, gjatë gjithë karrierës së tij, kur ka shërbyer në poste të ndryshme të larta të shtetëtare. Gjatë takimit u shpreh vullneti i qartë mes palëve për të ecur përpara në raportet dypalëshe. Presidenti Papulias tha se, "marrëdhëniet dypalëshe shqiptaro-greke janë të një rëndësie ekzisten-

cialë për rajonin". Njëherësh Papulias shprehu mbështetjen e Greqisë në rrugën e Shqipërisë drejt anëtarësisë në BE. Në një vit të veçantë, ku vendet fqinje e partnere strategjike si Greqia e më pas Italia, kanë kryesimin e BE-së, Ministri Bushati vlerësoi angazhimin e Greqisë për përshpejtimin e in-

tegrimit evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ai ndodhet në Greqi në kuadër të aktiviteteve të rëndësishme shumëpalëshe, Takimit të XVI të Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme të Nismës Adriatiko-Joniane dhe Konferencës së Strategjisë së BE-së për Rajonin e Adriatikut e Jonit (EU-



Bushati dhe Papulias

Bisedimet
"Të gatshëm të bisedojmë për çështjet e pa adresuara, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve e janë me interes të ndërsjellë për dy vendet tona".



KOMISIONERI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në zbatim të Ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Për statusin e nëpunësit civil", neni 15; të Vendimit të KM-së nr. 342, datë 07.07.2000 "Për lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë", si dhe të Vendimit nr. 225, datë 13.11.2008 të Kuvendit të Shqipërisë "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale";

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KMPD) shpall konkurrimin nëpërmjet ngritjes në detyrë, për vendin e lirë të punës në pozicionin:

Drejtor Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun

A. Përshkrimi i Punës:
Është nëpunësi civil i nivelit të mesëm drejtues (kategoria II-B) që menaxhon drejtorinë dhe koordinon punën për prirjen e kërkesave-ankesave, orienton dhënien e përgjigjeve direkte si dhe bashkëpunon me Drejtorinë e tjera për një trajtim më të thellësi, për rivendosjen e të drejtave të shkelura të ankimesit. Koordinon punën për pasurimin e faqes së internetit të KMPD-së me të rejtat e veprimtarisë së KMPD-së. Organizon punën për një komunikim të vazhdueshëm me opinionin në rrugë elektronike, postare apo telefonike. Përgatit dhe jep deklaratat për shtypin lidhur me Opinionin e Komisionerit, krijon e ruan marrëdhënie të ndërsjella e korrekte me median si dhe merr pjesë në formatet televizive për këtë qëllim. Mban marrëdhënie profesionale në nivel të lartë me autoritetet ndërkombëtare homologe sa i përket promovimit dhe publikimit të veprimtarisë së KMPD-së.

B. Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:
- Të ketë mbaruar arsimin e lartë në Shkencë Sociale ose Juridik.
- Të gëzojë aktualisht Statusin e nëpunësit civil.
- Të ketë eksperiencë pune në administratë jo më pak se 5 vjet.
- Të njohë e të zbatojë kuadrin ligjor ekzistues në përgjithësi dhe në veçanti të këtë njohuri të mira të Kodit të Procedurave Administrative dhe të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe akteve ligjore e nënligjore në këtë fushë.
- Të respektojë të drejtat e lirisë themelore të njeriut si dhe të njohë e të zbatojë rregullat e etikës në administratën publike.
- Të ketë aftësi të mira koordinuese, drejtimit, komunikimi e të punës në grup si dhe të ketë aftësi të mira komunikimi, kryesisht me median e publikun.
- Të zotërojë në nivel të kënaqshëm gjuhën angleze në të folur e në të shkruar, si dhe gjuhë të tjera që përbejnë avantazh.
- Të njohë e të përdorë kompjuterin, sistemin operativ windows dhe aplikacionet bazë të Office (word, excel etj.), si dhe të jetë i aftë të përvetësojë përdorimin e programeve që lidhen me objektin e punës. Të ketë njohuri bazë në fushën e teknologjisë së informacionit, pjesë të së cilës duhet të menaxhojë dhe drejtojë programe, faqe web-i, sisteme e rrjete sociale etj).
- Të jetë i aftë për përpilimin e opinionëve ligjore drejtuar titullarit të institucionit, mbi bazën e të dhënave e informacioneve të menaxhuara.
- Përben avantazh kryerja e kualifikimeve të ndryshme në fushën e medias ose të ketë punuar në sektorë të njëjtë me profilin që kërkohet si dhe eksperiencë e punës në fushën e gazetarisë, kryesisht të ketë mbuluar fushën e sistemit të drejtësisë dhe atë legjislativ.

C. Nga procedura e ngritjes në detyrë përfitojnë vetëm nëpunësit civilë ekzistues që aktualisht janë në shërbimin civil.

C. Dokumentat që duhen paraqitur:
- Kërkesë me shkrim për pjesëmarrje në konkurrim.
- Dokument identifikimi.
- Curriculum Vitae.
- Fotokopje e diplomës së shkollës së lartë dhe e listës së notave.
- Vërtetim nga institucioni i administratës publike apo i pavarur ku punojnë, që vërteton pozicionin aktual të punës sipas përcaktimit në pikën C.
- Dëshmi të gjuhës së huaj angleze dhe të çdo gjuhe tjetër.
- Kopje të dokumentave apo dëshmi, nëse ka, për tituj, kualifikime master, grada e publikime shkencore, etj.
- Vlerësimet individuale të nëpunësit civil, të viteve të fundit (maksimumin tre vjet).
- Fotokopje e libërës së punës.

Dokumentacioni duhet të paraqitet në gjuhën shqipe. Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell shkallëfikim të kandidatit.

D. Kandidati duhet të paraqesë dokumentacionin e mësipërm brenda datës 07 Mars 2014, pranë Zyrave të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe Personelit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Rruga "Abdi Toptani", nr. 4, kati II; Tel: +355 4 2237200). Pas verifikimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur, më datë 12.03.2014, në Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale do të shpallet lista e konkurrentëve, të cilët do të vazhdojnë më tej konkurrimin, dhe më datë 17.03.2014 do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista me gojë.

DH. Konkurrimi do të bazohet në njohuritë dhe kërkesat e veçanta për fushën e specialitetit, në ligjin nr. 9877, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", indryshuar, në Direktivën 95/46 EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, të 24 tetor 1995 "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe qarkullimin e lirë të të dhënave të tilla", në njohuri për Kushtetutën Republikës së Shqipërisë, në Ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 "Për statusin e nëpunësit civil" dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij, në Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", në Kodin e Procedurave Administrative.

DEPUTETI I LSI

Tavo: Bushati në Greqi në vëmendje toponimet

Deputeti i LSI Vangjel Tavo kërkoi dje zgjidhje sa më shpejtë të problemit me toponimet me shtetin grek. Në një konferencë për shtyp, ai theksoi se duhet një trajtim serioz të problemit nga dy shtetet. "Kërkoj vëmendjen e instancave përkatëse të shtetit për shqetësimin e mijëra qytetarëve shqiptarë me banim të përkohshëm në Greqi. Flap për të ashtuquajturin problem të "toponimeve" i cili prej shumë kohësh është pengesa kryesore në kalimin e lirë të kufirit shqiptaro-rek dhe anasjelltas nga shtetasit shqiptarë që kanë lindur në Greqi. S'mund të përbejë asgjë tjetër përveçse çudi dhe paradoks ky fakt për një vend si Shqipëria, që pretendon të fitojë statusin e vendit kandidat në Samitin e qershorit në Greqi. Kjo situatë është e pafalshme.



Vangjel Tavo

Në radhë të parë për ne, politikanët që po lëmë qytetarët tanë të vuajnë në vitin 2014", tha Tavo. Ai kujtoi vizitën që ministri i Jashtëm Ditmir Bushati kryen në Greqi sot dhe bëri këtë apel. Ministri ynë i Jashtëm, Ditmir Bushati, për një takim në kuadër të Kartës së Adriatikut, do vizitojë shtetin grek. Por së shpejti vjen në Tiranë Ministri i Jashtëm i Greqisë, Evangjello Venizelos. Të shërbejë si ftesë për trajtim serioz të problemit tashmë të njohur nga dy ministrat përkatës", tha Tavo.

VIZITA

Presidenti Nishani në Kongresin amerikan



Presidenti Bujar Nishani, ndodhet në Uashington për të marrë pjesë në Mëngjesin Kombëtar të Lutjeve. Dje, ishte në selinë e Kongresit ku u takua me disa anëtarë të Senatit dhe të Dhomës së Përfaqësuesve. Nishani u takua me njërin nga themeluesit e Grupit të Çështjeve Shqiptare në Kongresin amerikan, Engel. Presidenti dekoroi Grupin e Çështjeve Shqiptare me Medaljen e Flamurit Kombëtar. Kongresmeni Adelholt u dërgua me Medaljen "Gjergj Kastrioti Skënderbeu". Nishani u takua me senatorin Murphy, Kryetar i Nënkomisionit të Marrëdhënieve me Jashtë për Çështjet Evropiane në Senat, me senatorin e Oklahomës Inhofe, kongresmenin e Kalifornisë, Rohrabacher. Sot do marrë pjesë në Mëngjesin Kombëtar të Lutjeve.

» GRUPI PD

DEKLARATA Kreu i PD-së theksoi dje se rruga e vetme e integritimit në BE është bashkëpunimi me opozitën dhe jo duke goditur opozitën

Basha tërhiqet nga "skenari ukrainas" PD në Kuvend

Refuzimi i komisionit, opozita kërcënon me bojkot të parlamentit. "Nuk bëhemi fasadë e qeverisë"

ERVIN KOÇI
TIRANË

Lulzim Basha tërhiqet nga skenari ukrainas duke u rikthyer ërësh në Kuvend. Gjatë fjalës së djeshme në grupin parlamentar të PD-së, Basha theksoi se

Partia Demokratike do të zhvillojë sot një betejë në Kuvend për refuzimin që iu bë kërkesës së tyre për ngritjen e një komisioni hetimor për lëvizjet që janë bërë në administratën e Policisë së Shtetit. "Me këtë bindje, që duan ta ndajmë me gjithë njerëzit e lirë dhe të mençur të Shqipërisë, opozita do ta vazhdojë luftën, duke

filluar me seancën e nesërme që duhet ta kthejmë në një arenë të madhe të ndeshjes së ligjit me me antiligjin, në një aulë të gjyqit të ligjit ndaj antiligjit, që nuk mund të marrë peng demokracinë dhe shqiptarët", - theksoi Basha. Por kjo deklaratë e tij bie në kontrast me qendrimin që opozita mbajti dy ditë më parë

me deklaratën e deputetit Eduard Halimi i cili theksoi se vendi po shkon drejt skenarit ukrainas, pra që opozita do të dali me protesta të fuqishme për rrëzimin e qeverisë, ashtu siç po ndodh në Ukrainë. Kështu, kreu i PD-së duket se e ka menduar dy herë qendrimin që do të mbajta për në aktivitetin e saj politik.

MBLEDHJA

Ashtu si edhe në mbledhjet e fundit, pjesë e këtij takimi të grupit parlamentar demokratik ishin pothuajse të gjithë deputetët e PD-së. Kjo gjë ndodh sa herë në sallën e grupit të PD-së shkon ish-kryetari i tyre Sali Berisha. E gjithë fjala e gjatë e kreu të Partisë Demokratike, Lulzim Basha, u përqendrua tek refuzimi që Konferenca e Kryetarëve në Kuvendi i bëri kërkesës së opozitës për ngritjen e një komisioni hetimor për shkarkimet dhe emërimet që janë bërë në Policinë e Shtetit. Duke marrë shkas nga kjo, Basha e emërtoi Kuvendin në një farsë të mazhorancës duke kërcënuar se opozita mund ta bojkotojë aktivitetin parlamentar. "Opozita ka përcaktuar botërisht politikën e fokusimit të opozitës dhe fokusimit në aulën e Kuvendit të Shqipërisë, por në rast se Kuvendi do të katandiset siç po katandiset prej kësaj qeverie në gjyotinë e ligjit dhe kushtetutës, opozita nuk do të harxhojë asnjë ditë për tu bërë fasadë e kësaj farse dhe masakre, por do të vijojë misionin e saj pranë qytetarëve dhe me qytetarët", tha kreu i PD-së. Në vijim të fjalës së tij, Basha u ndal edhe tek çështja e integritimit të vendit në Bashkimin Europian. Ai tha se rruga e integritimit është bashkëpunimi me opozitën, pra konsensusi ndërmjet aktorëve të politikës shqiptare dhe jo me prishje konsensusi. "E këshillojmë të vërë në veprim menjëherë politikën e respektit ndaj nesh, ndaj grupit tonë parlamentar dhe aleatëve tanë opozitarë. E gjithë kjo në njohjen e të drejtave ligjore kushtetuese dhe përgjegjësisë të ndërsjellta politike në shërbim të demokracisë. Për t'u bërë të besueshëm në Bruksel, kryeministri shqiptar dhe shumica e tij duhet pikësepari të kapërcëjnë vetveten, pra të kapërcëjnë kujtimin dhe imazhin e forcës bllokuese kur ishin në opozitë. Por nuk mjafton. Rama dhe Meta duhet ta dinë se nuk shkohet



Mbledhje e grupit të PD-së

BERISHA:

"Dilni në protesta, po asgjësohet opozita"



Ish-kryeministri Sali Berisha akuzoi dje qeverinë se është vendosur për të shkatërruar opozitën. Në një deklaratë në faqe në tij në rrjetin social "facebook", Berisha mori shkas nga refuzimi që iu bë kërkesës së PD për ngritjen e një komisioni hetimor duke shkruar se populli duhet të ngrihet në protestat me të fuqishme për të mbrojtur opozitën. "Ndaj i bëj thirrje popullit opozitar të ngrihet në protestat me të fuqishme dhe të mbrojë me çdo kusht opozitarizimin dhe opozitën e vërtetë të vendit", shkruan Berisha.

Lidington, vlerësim për punën e arritur nga qeveria

Ministri britanik vizitë në Tiranë, Basha i ankohet për qeverinë

Takimet
TIRANË



Edi Rama dhe David Lidington

Në ditën e dytë të vizitës në Tiranë, David Lidington, ministër i Shtetit në Mbretërinë e Bashkuar për Çështjet e Europës, zhvilloi një takim me kryeministrin Edi Rama. Siç njofton zyra e shtypit në Kryeministri, tema e bisedës ndërmjet tyre ka qenë prespektiva europiane e Shqipërisë. Kryeministri Edi Rama e njohu ministrin Lidington me reformmat e ndërmara, duke theksuar se pavarësisht se Shqipëria nuk mori statusin e vendit kandidat në muajin dhjetor, Qeveria shqiptare mbetet e vendosur në angazhimin e saj për përmirësimin e të gjitha prioritetëve të kërkuara në këtë proces. Ministri britanik zhvilloi dje një tjetër takim, me kreun e Kuvendit. Meta i cili vlerësoi marrëdhëniet mes dy vendeve si të shkëlqyera dhe theksoi se Britania e Madhe përfaqëson një partner shumë të rëndësishëm për të ardhmen e Shqipërisë dhe rajonit tonë. Lidington vuri në

dukje gjithashtu se Mbretëria e Bashkuar mbetet e përkushtuar ndaj Shqipërisë dhe rajonit, dhe në këtë kontekst është e gatshme të zgjerojë mbështetjen e saj në avancimin e reformave prioritare të Shqipërisë. Pas takimit me dy krerët më të lartë të mazhorancës qeverisëse, ministri britanik zhvilloi edhe një takim me kreun e opozitës, Lulzim Basha. Në këtë takim Basha theksoi problematikat e opozitës ndaj mazhorancës ku i listoi Lidingtonit të gjitha ankesat e PD-së. Basha theksoi në takim edhe refuzimin e ngritjes së dy komisioneve parlamentarë nga ana e qeverisë duke i cilësuar këto so shkelje e hapur e kushtetutës.

TAHIRI-LIDINGTON

Byroja e Hetimit, merret "bekimi" nga Britania

Byroja Kombëtare e Hetimit është në fazat e saj të fundit. Lajmi bëhet iditur nga vetë Ministri i Brendshëm Saimir Tahiri i cili e pohoi këtë gjatë takimit me ministrin britanik David Lidington. Sipas njoftimit të Ministrisë së Brendshme mësohet se temë e diskutimit ndërmjet dy ministrave ka qenë çështja e ngritjes së Byrosë Kombëtare të Hetimit, gjë kjo që është përgëzuar nga Lidington. Ministri Tahiri është shprehur se puna për ngritjen e Byrosë Kombëtare të Hetimit është në fazat e fundit të përgatitjes së draftit, i cili shumë shpejt do të paraqitet qeverisë për miratim. Aika theksuar



se Byroja së bashku me Policinë e Shtetit do të rrisin efikasitetin e goditjes së kriminit të organizuar, korrupsionit dhe trafikëve të paligjshme. Duke vlerësuar bashkëpunimin e deritanishëm policor dhe rezultatet, Ministri Britanik ka siguruar gadishmërinë e qeverisë së Britanisë së Madhe për asistencë të kualifikuar lidhur me Byronë Kombëtare të Hetimit duke i dhënë në këtë mënyrë bekimin për ngritjen e kësaj strukture e cila është kundërshtuar fort nga opozita shqiptare. Krahas kësaj, Tahiri theksoi se Policia e Shtetit është e vendosur për të kryer disa detyra që lidhen edhe me integritimin e vendit në BE.

në Europë me arrogancë, duke goditur konsensusin, duke goditur ligjin dhe kushtetutën, duke goditur institucionet e pavarura, duke hedhur në erë urat e bashkëpunimit me opozitën. Nuk shkohet në Bruksel, kryeministri shqiptar dhe shumica e tij duhet pikësepari të kapërcëjnë vetveten, pra të kapërcëjnë kujtimin dhe imazhin e forcës bllokuese kur ishin në opozitë. Por nuk mjafton. Rama dhe Meta duhet ta dinë se nuk shkohet


Anullimi



ILIR SINANAJ
TIRANE

Dje Këshilli i Ministrave miratoi vendimin për të shfuqizuar VKM-në Nr.600, datë 12.9.2007, "Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë". Ky vendim i Qeverisë vjen pas auditimit të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, në lidhje me kriteret, sipas të cilave kishin përfituar kredi të lehtësuar zyrtarë të lartë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë. Në vendim i Qeverisë vjen pas auditimit të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Eglantina Gjermeni, në një seancë të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Shqipërisë. Vendimi i Qeverisë për të anuluar kreditë e buta do të thotë se ata që e kanë marrë këtë kredi, do t'u duhet t'i shlyejnë ato me interesa të plota, në përputhje me

Gjermeni
"Zyrtarë të lartë dhe funksionarë politikë kanë përfituar një kredi të dytë për të blerë banesë jashtë vendit të ushtrimit të detyrës, madje edhe në zonat turistike"



Këshilli i Ministrave: Anullohen kreditë e buta për zyrtarët

Funksionarët politikë që kanë marrë kredi nga kjo skemë, tashmë shlyerja sipas kushteve normale të bankave

kushtet e bankave, nga ku ato janë marrë.

FONDET

Ministria Gjermeni bëri të ditur se sipas vendimit të këshillit të Ministrave, fondet nga buxheti i shtetit, të cilat ishin alokuar për zyrtarët e lartë, tashmë do

të kalojnë për ato familje që janë në nevojë, duke përfituar një kredi me interes 0%. "Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit vendosi të mos trajtojë më në mënyrë të privilegjuar zyrtarët e shtetit. Vendimi i Këshillit të Minis-

trave parashikon, që fondet e planifikuara në buxhetin e shtetit për zyrtarët, të alokohen në kategoritë e tjera më në nevojë për strehim siç janë familjet që banojnë në ish-pronë të subjekteve të shpronësuara, të cilat përfitojnë kredi me interes 0%", deklaroi ajo.

AUDITIMI

Abuzimet në skemën e kredive të buta kanë arritur, sipas auditimit, deri në pikën ku funksionarë politikë të administratës "Berisha" kanë përfituar një kredi të dytë për të blerë një banesë në zona turistike. "Janë gjetur raste të trajtimit me

kredi për shtëpi të funksionarëve që kanë në pronësi një apo dy shtëpi. Dhe zyrtarë të lartë dhe funksionarë politikë kanë përfituar një kredi të dytë për të blerë banesë jashtë vendit të ushtrimit të detyrës, madje edhe në zonat turistike", bëri të ditur ministria Gjermeni.

TATIMET 2013

Biznesi i Vogël, afati i deklarimit deri në 10 shkurt

— Afati i dorëzimit të deklarimit të Të Ardhurave Personale të Biznesit të Vogël (TAPBV) për vitin 2013 është data 10 shkurt 2013. Ministria e Financave njofton se, sipas Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, subjektet e kësaj take duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë deklarimet pranë Administratës Tatimore. Dorëzimi i deklarimit të TAPBV-së kryhet vetëm në mënyrë elektronike. Pagesa e diferencës së Taksës Vendore mbi Biznesin e Vogël, mund të kryhet nëpërmjet bankave të nivelit të dytë ose sporteve të Postës Shqiptare. Biznesi i Vogël përkufizohet të gjitha ato subjekte sipërmarrëse që kanë një qarkullim kapitali vjetor nga 2 milionë deri 8 milionë lekë.



Ministria e Financave

PROTOKOLLI I BASHKËPUNIMIT

Ndërtuesit: Të gatshëm për banesat sociale

— Është thelluar bashkëpunimi midis Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit (MZHT) dhe Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë. Dje ministria Gjermeni dhe drejtori i Bordit të Shoqatës së Ndërtuesve nëshkruan Protokollin e Bashkëpunimit. Ajo që vlen të theksohet nga kjo marrëveshje është fakti se Shoqata është e gatshme për bashkëpunim në rishikimin e Ligjit të Planifikimit të Territorit si dhe rregulloreve përkatëse, me qëllim finalizimin e një legjislacioni të plotë, efektiv dhe lehtësisht të zbatueshëm, për një zhvillim të qëndrueshëm në interes të vendit e shoqërisë. Nga ana tjetër si Ministria ashtu edhe Shoqata kanë rënë dakord të vënë në dispozicion të njëra-tjetrës specialistët më



të mirë për çështje të interesit të përbashkët. Gjithashtu, Ministria dhe Shoqata angazhohen bashkërisht për zgjidhjen e problemit të strehimit, në fushën e banesave sociale. Ministria do të vendosë në dispozicion të dhënës dhe duhura, ndërsa Shoqata do të impenjohet me specialistët dhe anëtarët e saj për identifikimin dhe hartimin e një platforme që synon t'i japë zgjidhje sa më të shpejtë problemit të të pastrehëve në vend.

Investimet
TIRANE

Në një VKM të veçantë, janë përcaktuar dje kriteret e dhënies me qira apo enfitozë të pronave shtetërore. Në të, interesante është veçanërisht pjesa ku përcaktohet dhënia me qira me çmimin simbolik një euro, për oferta investimi të larta apo veprimtari fason. Madje, edhe kontratat e qirasë të lidhura para daljes së këtij vendimi, ku realizohet veprimtari prodhuese me regjim "fason", kthehen në kontrata me tarifë simbolike një euro/kontrata, pas daljes së këtij vendimi, duke ruajtur si garanci kontrate atë të kontratës së qirasë.

Qira 1 euro për pronat shtetërore, ja kush përfiton

Projekti i qeverisë favorizon "fasonët" dhe investimet mbi 10 mln euro



Kontrata me një euro do të akordohen në raste kur pasuritë shtetërore janë me sipërfaqe mbi 500 m2. Ose kur rezultojnë fitues një subjekt i cili propozon që në pasurinë shtetërore që jepet me qira

do të zhvillohen aktivitetet, si veprimtari prodhuese industriale mbi 10 milionë euro investim apo fason. Mund të jepet edhe në raste propozimi për kryerjen e investimeve në vlera mbi 2 milionë euro për,

Enfitozoa
Është një kontratë, me të cilën një personi i jepet e drejta të përdorë dhe të përmirësojë një pasuri të paluajtshme, kundrejt një shpërbërimi periodik në të holla ose në natyrë.

për veprimtari në fushën e sportit, kulturës, turizmit dhe trashëgimisë kulturore. Para nënshkrimit të kontratës së qirasë, me tarifë 1 euro/kontrata, qiramarrësiduhet të paguajë garanci 10 për qind të investimit të marrë përsipër në konkurrim, që kthehet pas përfundimit të investimit. Në rast se subjekti, që ka lidhur një kontratë me tarifë 1 euro/kontrata, nuk realizon kushtet e saj, kontrata kthehet në kontratë qiraje.

» INTERVISTA

HANS ULRICH OBRIST
TIRANE

Edhe në epokën tonë, kur na duhet të bëjmë njëkohësisht një pafundësi punësh të ndryshme, pak artistë janë bërë liderë botërorë dhe pak liderë botërorë artistë. Por, kryeministri Edi Rama i Shqipërisë është pikërisht ai hibrid i jashtëzakonshëm: Një piktor i njohur dhe pedagog në Akademinë e Artit gjatë viteve '90, ai u bë kryetar i Bashkisë së Tiranës në vitin 2000 dhe mori mandatin aktual Qeverisë vitin e kaluar. "Artforum" nga Nju Jorku ftoi kuratorin e artit Hans Ulrich Obrist për të biseduar me Ramën, së bashku me bashkëpunëtorin e tij të shpeshtë në fushën e artit dhe politikës, Anri Sala, dhe për të zbuluar hollësitë, që rrethojnë reformat e tij ambicioze estetike dhe sociale.

Hans Ulrich OBRIST: A do ta quanit veten një artist-aktivist?

EDI RAMA: Kur isha i ri, po. Politika më ka tërhequr gjithmonë, por kurrë nuk kam dashur të hyjë në politikë zyrtarisht. Po bëja një jetë si udhëtar – duke shitur punime arti, duke blerë bileta avioni, duke zbuluar botën. Por në të njëjtën kohë, kam kam bërë gjithmonë shkrime kundër një gjëje apo një tjetre, duke qenë si një lloj ngatërrestari profesionist. Së fundi, isha një piktor, i cili ishte zënë nmes të ngjyrave dhe konflikteve: Punimet e mia ishin si një model abstrakt, një kod për një lëvizje të fshehtë.

Jam pothuajse pesëdhjetë vjeç. Por që në fillim, mendoj se ka qenë fakti që kam nisur të bëj art në skaj të regjimit komunist – kur Akademia e Arteve ishte ende tërësisht e kontrolluar dhe realizmi socialist ishte e vetmja metodë e pranueshme, por kur ka pasur edhe mënyra për të shpëtuar, nëse përdorje imagjinatën – kjo më bëri si një artist-aktivist. Në një mënyrë, i gjithë arti jo-akademik por edhe diskursi në atë kohë, në këtë situatë, mund të shihej si aktivist – një rrugë për të dalë në anën tjetër të murit, qoftë në mënyrë formale apo të drejtpërdrejtë.

OBRIST: Dhe më pas u përfshitë së tepërmi me lëvizjen studentore; pasi qeveria komuniste ra, ju filluat të jepnit mësim në Akademi. Është një kohë marramendëse, dhe ju flisni për disa nga kryqëzimet mes utopive të politikës e artit, dhe korrupsionit e tyrë që pasoi, në librin tuaj "Refleksione [1991]".

RAMA: Po. E kam shkruar me një mikun tim, Ardian Klosi, një nga figurat kryesore të protestave anti-komuniste, i cili në mënyrë tragjike kreu vetëvrasje vitin e kaluar. Kishim menduar ta ribotim atë, duke shtuar një kapitull në lidhje me vitet e më vonshme, për shkak se doli mjaft profetik. Klosi dhe unë ishim shumë të mërzitur, që nga momenti e para të ndryshimit, me mënyrën se si lëvizja demokratike po manipulohej. Ishte partia e parë opozitare e njohur nga regjimi, dhe ajo u kthye në një lloj të lëvizje populiste të shtirë. Sheshet e qytetit ishin plot me njerëz, dhe plot me energji të çuditshme - ju mund të

NË FOTO:
Fatos Nano
dhe Edi Rama

Edi Rama: Si u bëra Ministër i Kulturës me një telefonatë

Kreu i qeverisë në një intervistë ndryshe, flet për të jatën, shokët dhe objektivat për të ardhmen

ndjenit mosmarrëveshje dhe urrejtjes për rreth, por asnjë parashikim pozitiv, asnjë pamje të së ardhmes. Turnat po keqëroreshin, ata u bënë një lloj dekorati. "Reflektimet" tona ishin më shumë si një diagnozë dhe një alternativë – duke parë nga brenda në kundërshtitë të lëvizjes së jashtme ulëritëse.

Rreth kësaj kohe, Ardiani dhe unë organizuan një event në sallën e vjetër të teatrit në Akademi: pa tribunë, pa skenë, pa panel, asgjë përveçse një hapësirë të errët. Njerëzit nuk mund të shikonin njëri-tjetrin, kështu që e gjitha ishin vetëm zërat. Mikrofooni u dërgua nga një vende në tjetrin dhe njerëzit mund të dëgjojnë zëra që që nuk i njihnin, zërat që villnin të vërteta, që në një rast tjetër njerëzit do të kishin frikë t'i thonin në publik. Kjo ishte hera e parë që situata u shpreh në mënyrë të qartë, dhe kjo solli një pozicionim shumë të shpejtë, radikal kundër regjimit.

OBRIST: Por pastaj ju shkuat në Paris, ku jetuat me Anri Salën. Si u rifutët në politikën shqiptare?

RAMA: Në vitin 1998, babai im vdiq nga një atak në zemër, dhe planifikova të rikthehesha në Shqipëri për 3 ditë për funeralin, por ndërkaq qëndrova për gjithmonë. Im atë dhe unë ishim shumë të afërt me njëri-tjetrin. Por edhe hareshim vazhdimisht: Ai ishte një komunist ndërsa unë isha një anti-komunist. Ai ka qenë një artist zyrtar shumë i njohur, ndërsa unë në mënyrë të vendosur kundër artit zyrtar. Por ai ishte gjithashtu një njeri i tolerant dhe unë do t'i jem gjithmonë mirënjohës që më lejoi të rriten pa më kujtuar në mënyrën time të të menduarit. Kur ai vdiq, ishte e tmerrshme. Pas funeralit, në dhomën e pritjes në shtëpinë tonë, shkova të bëja kafë në kuzhinë. Ra telefoni, dhe ishte kryeministri, Fatos Nano, i cili kryesonte qeverinë e riorganizuar pas trazirave politike dhe kolapsit ekonomik të vitit 1997. Ai më pyeti drejtpërdrejt: "Zoti Ministër i Kulturës, do të qëndrosh apo do të

ikësh?" Po propozuar që të marrja një pozicion në kabinetin e tij. Dhe pa ngurrur i thashë: "Do të rri". Ai tha: "Vërtet? Do më shumë kohë për t'u menduar?" Unë iu përgjigja: "Po u mendova, do të iki." Ai e mbylli telefonin. Më vonë, në zyrën më kërkuan CV-në time, dhe unë vetëm shkruajta: "Edi Rama, i lindur në 4 korrik. Kjo mjafton". Dhe pastaj një ditë më vonë, u bëra ministër i Kulturës, dhe jeta ime ndryshoi përgjithmonë.

OBRIST: Sa shqiptarë të vërtetë kanë akses në internet? Rama: Ne kemi bërë shumë progres.

OBRIST: Si mundin të përkthehen në hapësirë fizike publike platformat tuaja digjitale?

RAMA: Po ja, një gjë që dua të bëj është të ndërtoj një muze ndërfetar.

Karakter

Politika më ka tërhequr gjithmonë, por kurrë nuk kam dashur të hyjë në politikë zyrtarisht. Po bëja një jetë si udhëtar – duke shitur punime arti, duke blerë bileta avioni, duke zbuluar botën. Por në të njëjtën kohë, kam kam bërë gjithmonë shkrime kundër një gjëje apo një tjetre, duke qenë si një lloj ngatërrestari profesionist

Shqipëria është një rast unik për arsye se muslimanët, të krishterët ortodoksë, katolikë, të gjithë të bashkëjetojnë në paqe atë. Ne patëm një periudhë të tmerrshme persekutimi nën sundimin komunist, kisha u hodhën në erë me dinamit dhe veprat fetare të artit u dogjën në rrugë. E megjithatë ne gjithashtu, historikisht, kemi pasur një atmosferë me tolerancë të madhe. Një muze si ky do të mund të shqyrojë të gjithë rajonin e Ballkanit, gjithashtu, ndoshta duke bashkuar breza të rinj të shqiptarëve nga Sh-

DEKLARATAT Për "Artforum"
Edi Rama dhe Anri Sala flasin për krijimin e një muzeu ndërfetar si edhe çfarë mund të bëhet në një të ardhme me vilën e Enver Hoxhës

qipëria dhe Kosova, si dhe serbë, malazezë, maqedonas, grekë, si pjesë e një historie të përbashkët besimesh. Brezat e rinj nuk kanë fare djepi për komunizmin dhe krimet e tij: Ata nuk e jetojnë atë, dhe nuk e kuptojnë atë, ata nuk shqetësohen për atë, dhe janë indiferentë për mënyrën se si kemi arritur deri në këtë pikë si një shoqëri në harmoni për sa i përket besimit, dhe cilat mund të jenë rrezikët duke e marrë atë si të mirëqënë.

SALA: Është risi të mendosh për rajonin si një komunitet i pikash të përbashkëta, se sa si vende të vetmuara ose shtojca në skaj të Europës.

RAMA: Muzeu do të aktivizojë këtë histori ndërkulturore, jo vetëm me ekspozita, por edhe me hapësira për workshop-e, debate, konferenca. Ajo nuk duhet të jetë një hapësirë e ngjirë, zyrtare, ku ju shkonit të shihni në mënyrë pasive. Ne kemi zhvilluar tashmë një konkurs për dizension e muzeut, një komponent që e kam përzemër në veçanti është kopshti i muzeut, tek i cili do të ketë bimë të përmendura në Bibël, Kuran, dhe libra të tjera të shenjta.

SALA: Në të njëjtën kohë, kjo nuk është vetëm për ndërtimin e muzeve të reja. Ka objekte ekzistuese të tilla si piramida – mauzoleu surreal i braktisur ndërtuar për Enver Hoxhën – i cili nuk mund të rikonceptohet për të marrë një rol të ri, një përdorim tjetër.

RAMA: Dhe ish-rezidencën e Hoxhës, gjithashtu. Më pëlqen vërtet ideja e përdorimit të saj si një bujtinë lagaje. Duke mbajtur shtëpinë ashtu siç është, duke mbajtur çdo gjë, madje edhe mobiljet e Hoxhës – por duke ndryshuar natyrën e jetës brenda. Për momentin, kjo është një rezidencë qeveritare, por ajo mund të jetë një bujtinë për shumë njerëz, një vend për çdo gjë dhe gjithçkush që Hoxha do të kishte urreyer të kishte përrreth. Ai do të urrente të kishte atje një artist bashkëkohor.

SALA: Ajo do të ishte si një transfuzion gjaku. Gjithashtu ti mund ta hapësh atë për publikun. Tani për tani, është e mbyllur prapa mureve, siç ishin aq shumë hapësira nën regjimin e Hoxhës. Por nëse e kthen një pjesë të kopshtit të saj në një park -

RAMA: Po, dua të hap kopshtin që rrethon shtëpinë. Përpara, e tërë zona – e përbërë nga disa blloqe që përfshinin të gjitha rezidenca e drejtuesve të Byrosë Politike – ishte komplet e ndaluar, e mbrohej me ushtarë të armatosur. Dhe kur u hap më në fund, në vitin 1991, rrugët ishin mbushur me turma, të cilat kurrë nuk kishin pasur mundësinë as ta shikonin atë, le pastaj të ishin aty brenda. Pak më vonë, kur e kam parë veten shtëpinë, u trondita. Pata një ndjesi të pabesueshme të. Kemi një njeri që e mbante këtë shtet nën thundrën e tij për vite, dhe pastaj shikohet një shije kaq banale dhe mënyra e tij krijësisht banale e të jetuarit.

NË FOTO:
Kryeministri
Edi Rama

Siguria

ELTON QYNO
TIRANE

Për vënien në përdorim të 9 radarëve, të cilët prej dy vitesh kanë dalë jashtë funksionit dhe askush nuk është kujtuar për riparimin e tyre, me qëllim garantimin e sigurisë kombëtare detare, në muajin janar është zhvilluar në ministrinë e Mbrojtjes një tender me një vlerë prej 600 milion lekë të vjetra. Synimi i këtij tenderi është rikuperimi i difekteve, kryesisht në programet softëre dhe Hardisk, stabilizatorë, sheltër dhe difekte të ndryshme që kanë nxjerë jashtë gatishmërisë, këtë sistem që duhet të transmetojë gjithçka në shërbim të sigurisë kombëtare. Projekti që i ka kushtuar 32 milion dollarë shqiptarëve, është arritur të vihet në puna nga ish-ministri i Mbrojtjes Pandeli Majko, por në dy vitet e fundit, kur ministria është drejtuar nga Arben Imami, ky sistem që transmeton të dhëna për çdo objekt që lundron apo shkel ujërat territoriale shqiptare, nuk funksionon qoftë edhe një minutë të vetme. Të gjithë radarët janë instaluar në 9 pika kyçe të bregdetit shqiptar nga kompania amerikane "Locheed Martin", të cilët shtrihen në një distancë që fillon nga Ksamili deri në zonën e Shëngjinit.

VJEDHJA E KABLLIT

Një nga radarët që është i koduar me PRT-19 dhe që ndodhet në vendin e quajtur "Guri i Gomarit" në zonën e Lushnjës ka dala jashtë gatishmërisë operacionale, për shkak se këtij radari i është vjedhur kabli elektrik. Ngjarja ka ndodhur vitin e kaluar, por sipas burimeve të "Shqiptarja.com" që nga dita e ndodhjes së këtij krimi e deri më sot, kabli elektrik në një gjatësi prej 200 metra nuk është zëvendësuar. Dyshimekt flasin se kabli elektrik është vjedhur nga vetë efektivi që shërbejnë në këtë bazë, por në fakt asnjëri prej tyre nuk ka dalë para drejtësisë. Burime të sigurta pranë Ministrisë së Mbrojtjes thanë se dhe është nxjerë një urdhër, për dërgimin e një gjeneratori në Pikën Radio Transmetuese 19 në zonën e Lushnjës, me qëllim vendosjen në punë të tij. Tashmë po bën rreth dy javë, që dhe inspektorët që cilët kanë fituar tenderin prej 600 milion lekë, janë duke kryer inspektime në teren në 9 Pikat Radio Transmetuese ku janë përqëndruar radarët detare. Këta të fundit prej dy vitesh kanë dalë jashtë përdorimit duke bërë që zyrtarë të lartë të ushtrisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të çënojnë realisht sigurinë territoriale detare.

RËNIA E OBJEKTIT

Njëri nga objektet ku është instaluar radari PRT-14 në llogara, rezultoi të jetë rëzuar dhe ka dalë jashtë përdorimit.


Zbardhet tenderi për rregullimin e mirëmbajtjes e radarëve

Mbrojtja 600 milionë lek, për nëntë radarët

Në Lushnjë u vodhën 200 m kabëll, çojnë gjenerator



RADARET	
Jashtë funksionit	
■ PRT-11	Ksamili
■ PRT-13	Porto Palermo
■ PRT-14	Llogara
■ QOV	Zvërnec
■ PRT-20	Durrës
■ PRT-22	Shëngjin
■ Monitorët	SVHD
■ PRT-19	Lushnjë
■ PRT-17	Sazani



Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë

dorimit. Ky objekt i ushtrisë Shqiptare ndodhet në vendin e quajtur "Maja e Thanasit", shumë pranë një godine që i shërben për transmetim të


valëve të televizionit shqiptar. Si pasojë e këtyre kushteve, i gjithë personeli ushtarak, tashmë rezultoi të ketë hyrë në objektin e radiotelevizionit

Shqiptar, ku edhe në këtë vend nuk arrin të kryejë asnjë detyrë ushtarake, për shkak të mosfunksionimit të radarit. Tashmë në këtë pikë

transmetimi kanë shkuar inspektorët të ushtrisë dhe kompanisë që ka marrë tenderin për vënien në përdorim të sistemit të radarëve.



Dy të parburgosurit që cilësohen si shkaktarë të rënies së zjarrit në burgun e Rrogzhinës, kanë deklaruar se gjithçka mes tyre kishte filluar një lojë brenda ambjentit të qelisë, por që shumë shpejt situata i ka dalë jashtë kontrollit. Dy të parburgosurit Ledion Gjika dhe Jurges Muçollari, kanë treguar se janë ndjerë të vetmur si pasojë e mos vizitave të kryera nga ana e familjarëve të tyre. Të ndjerë të braktisur, ata kanë filluar të luajnë me një bombël gazi, të cilin e kishin qelënë e tyre, pas jua kishin sjellë disa muaj më parë familjarët. Bombola e gazit ka hyrë në këtë burg, pasi institucioni i vuajtjes së dënimit në Rrogzhinë, nuk cilësohet si burg i sigurisë së lart, dhe se janë disa materiale që lejohen të futen në qelitë e të dënuarve. Teksa luani me njëri-tjetrin, dy të parburgosurit kanë deklaruar në prokurori se kanë vendosur ti venë zjarin dhomës së tyre, por gjithçka ka nisur si shaka. Gjika dhe Muçollari, kanë hapur gazin duke i kanë vënë zjarin bom-



'E filluam si lojë, por i vumë zjarrin burgut'

Dëshmitë e dy të parburgosurve që dogjën me gaz burgun Rrogzhinë

bëlës, fill pas saj morrën zjarr dhe dyshekët e krevatit, duke provokuar kështu flakët e mëdha. Në dëshminë e tyre dy të rinjtë janë shprehur se skanë pasur asnjë qëllim për tu arratisur, por gjithçka ka nisur si lojë. Ndaj tyre është ngritur akuzat e "Shkatërrimit të pronës me zjarr" kryer në

bashkëpunim. Ndërkohë nga burime pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve mësohet se në burgun e Rrogzhinës, vuajnë dënimin rreth 465 persona të dënuar dhe 229 janë persona që ndodhen në parburgim. Institucioni i burgjeve gjatë kësaj kohe ka marrë masa

të menjëhershme për pas-trimin e ambjentëve dhe lysterjen e qelive që u përfshinë në flakë, mme qëllim rikthimin sërisht të të dënuarve në qelitë e tyre. Pjesa më e madhe e të dënuarve gjatë kohës së evakuimit nga burgun, janë transportuar në burgun e Peqinit.

LAJME
shkurt

Korçë, e moshuara

gjendet e vdekur
Një grua 72-vjeçare është gjetur e vdekur në një fshat të Korçës, në një tokë pranë fshatit Çiflig. Kanë qenë banorët e zonës që e kanë gjetur dhe trupin e pajetë dhe kanë njoftuar policinë. Policia ka arritur në vendin e ngjarjes për zbardhjen e shkaqeve që i kanë sjellë vdekjen, ndërkohë që bëhet e ditur se gruaja është identifikuar nga familjarët si Donika Serani, 72 vjeçe nga fshati Çiflig dhe vuante nga skleroza. Ajo kishte 5 ditë që ishte larguar nga banesa e saj. Trupi i viktimës mësohet se është gjetur pasdite nga kalimtarë të rastit në fshatin Çiflig.



Gjon Kola

Ekstradohen i dënuari për trafik droge

I dënuar në Shqipëri me 6 vite burg për trafik droge, Interpoli Tirana ka bërë dje ekstradimin nga Italia të Gjon Kolës. Burime zyrtare nga Policia e Shtetit thanë se, i ekstraduar Gjon Kola, 47 vjeç nga Puka, është i dënuar nga Gjykata e Krimeve të Rënda në Tiranë, me 6 vjet heqje lirie për "trafik të lëndëve narkotike" dhe "falsifikim dokumentesh identiteti". "Që prej vitit 2009, 47-vjeçari ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar, ndërsa kapja e tij u bë e mundur në gusht të vitit 2012.

Durrës, sekuestrohen 8 kg kanabis sativa

Tetë kilogram drogë "Canabis Sativa", të cilat i janë gjetur në makinë para se të futej në traget e kanë çuar dje drejt prangave 26-vjeçarin Luan Lika. Automjeti i shtetasit në fjalë, "Volksvagen Passat" me targa AA 551 BA, u përzgjodh për kontroll nga shërbimet e Policisë gjatë kohës kur do imarkohet në tragetin "Michela" të linjës Durrës - Bari, rreth orës 23.00.

Transferimi

Pjesa më e madhe e të dënuarve gjatë kohës së evakuimit nga burgun, janë transportuar në burgun e Peqinit.

NË FOTO:
Burgu i Rrogzhinës



Momenti i shpërthimit të eksplozivit brenda në godinë



Shpërthimi

Tre herë ka dhënë urdhërin për zjarr shefi i komisarariatit nr.1 në Tiranë, dhe në të gjitha rastet shpërthimi nuk është realizuar.



LAJME
shkurt

Vodhi bankën në Greqi, dënohet Fier

Gjykakta e Fierit ka shpallur fajtor shtetasin Afrim Koçaqi duke e dënuar këtë të fundit me 4 vite burg për akuzën e "Pastrimit të produkteve të vepërës penale". Koçaqi rezultoi të jetë autor i grabitjes së një banke në Greqi, dhe më pas është kthyer në Shqipëri ku ka depozituar shumën prej 250 milion lek të vjetra në një bankë shqiptare. Tashmë kjo shumë është sekuestruar.



Aksidentohet urbane shoferi i dehur

Një autobus i linjës së Unazës në kryeqytet është përplasur me një automjet, por nuk ka pasur persona të lënduar. Ngjarja u shënuar në mënyrë tek zona e "Bryllit", ku autobusi është aksidentuar me një furgon. Pas hetimeve të kryera nga policia u pa se shoferi i urbane ishte në gjendje të dehur. Testi i alkoolit që i është bërë ka treguar se ai kishte konsumuar pije alkoolike dhe për këtë arsye është shoqëruar në komisarariat.

Urdhëri për "zjarr" shoqërohet me të qeshura në zonë

Pas 3 dështimeve Dajti shemb shtatë katëshin

Xheniot dhe INUK nuk arrijnë rrëzimin në 3 prova

Objekti
ELTON QYNO
TIRANË

Pas tre dështimeve të një pas njëshme, forcat e INUK dhe Policisë së Shtetit, kanë arritur të rrëzojnë rreth orës 15:30 objektin 7 katësh që ishte ngritur pa lejë, buzë rrugës së Elbasanit. Godina i përkiste shtetasit Artur Nilani, i cili dy ditë më parë ka pretenduar se objekti është në proces legalizimi dhe nuk mund të kryejë asnjë veprim, deri në përfundim të këtij procesi. Mirëpo, ky pretendim nuk është marrë parasysh nga forcat e INUK, të cilët më ndihmën e policisë kanë arritur të largojnë pronarët dhe të hyjnë në objektin 7 katësh, duke filluar të hapin vrima për instalimin e tritolit, me qëllim shembjes e objektit pa lejë. Forcat e INUK kanë punuar përgjatë natës dhe se mëngjesin e djeshëm filluan të instalojnë tritolin në vrimat e hapura.

Për rrëzimin e objektit është dhënë tre herë urdhëri por në fakt, në të treja rastet është shoqëruar me të qeshura nga të pranishmit, pasi lënda eksplozive nuk ka shpërthyer.

PLASJET E DESHTUARA

Tre herë ka dhënë urdhërin për zjarr shefi i komisarariatit nr.1 në Tiranë, dhe në të gjitha rastet shpërthimi nuk është realizuar. Kjo si pasojë e një çarku të shkurtër elektrik dhe se 10 prej kapsolëve nuk kanë funksionuar. Pasi forcat e INUK dhe ato të xhenios kanë kryer riparimet e mundshme, sërish urdhëri për rrëzimin e objektit 5 katësh ka dështuar. Në të treja rastet e ka dhënë urdhërin shefi i komisarariatit nr.1 Artion Duka, ndërsa në provën e katër urdhërin për zjarr e ka dhënë vetë kryeinspektori Zyhdë Dajti, i cili pasi ka përfunduar numërimin mbrash, ka aktivizuar dhe shpërthimin duke rrëzuar në tokë godinën 5 kate që ishte ndërtaur pa lejë, në afërsi të rrugës së Elbasanit. Për gjatë ditës së djeshme janë mbajtur të bllokua 3 rrugë,

në të cilat është lejuar kalimi i automjeteve vetëm në orët e vona të mesnatës së djeshme.

PASTRIM INERTEVE

Pastrimi i inerteve është bërë nga INUK-u pasi vetë pronari i ndërtesës, Artur Nilani, nuk ka pranuar të pastrojë mbetjet, me pretendimin se nuk duhej

prishur ndërtesa. Fill pas shembjes së goditës një eskavator i INUK dhe disa automjete kanë filluar të heqin pjesën e betonit të grumbulluar. Ky është objekti i katërt që INUK shemb, duke përdorur tritolin. Tre objektet tjera janë shembur në Vlorë dhe Tiranë me të njëjtën mënyrë.



NË FOTO: Gërmadhat e mbetura nga shpërthimi

Gardiani i burgut merr "peng" shoferin

Policia arreston Ismail Krasniqin. E denocoi shoferi i kamionit në Kavajë

Prangosja
KAVAJE



Një efektive policie është arrestuar mbrëmë në qytetin e Kavajës, pasi ka kanosur me armë një shofer kamioni. Ngjarja është shënuar rreth orës 21:00 dhe i prangosuri është Ismail Krasniqi, 40 vjeç, banues në Qerret, Kavajë, me detyrë punonjësi policie në burgun e Rrogzhinës. Ndalimi ka ardhur pasi ky person ka detyruar një shtetas të huaj, i cili është shofer kamioni, duke e detyruar nën kërcënimin e

armës që ta çonte me makinën e tij nga Rrogzhiina drejt Kavajës. Ndalimi u bë pasi ishte shoferi i kamionit ai i cili bëri një kallëzim në polici, ku shprehej se faktivi e kishte kanosur me armë e shërbimit. Fill pas kësaj, policia e Kavajës ka kryer disa verifikime dhe ka arritur të mësojë se gardiani që ka kanosur me jetë shtetasin e

huaj është Ismail Krasniqi. Ky i fundit është shoqëruar në komisarariat e Kavajës ku është gjatë ditës së djeshme në pyetje. Në dëshminë e tij Krasniqi ka treguar se kishte mbetur mes katër rrugëve, dhe se askush nga kalimtarët e rastit, nuk po e merte për ta çuar në drejtim të Kavajës, ku dhe ka familjen. I ndodhur në këto kushte, gardiani ka preferuar të përdorë armën e shërbimit për të ndaluar një kamion me targa të huaj, shoferin e të cilit e ka detyruar me anën e pistoletës të udhëtojë në drejtim të Kavajës. Sapo ka mbërtur në afërsi të qytetit, gardiani ka zbritur nga kamioni dhe është larguar me vrap, ndërkohë drejtuesi i mjetit i është drejtuar policisë, ku dhe ka bërë kallëzim penal.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE

NJOFTIM PËR VENDE TË LIRË PUNE

Mbështetur në ligjin 7961 datë 12.07.1995, Kodi i punës i ndryshuar, në VKM Nr 120 datë 27.02.2003 për krijimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore, ligji nr 7893 datë 22.12.1994 për zhvillimin e Shkencës dhe Teknologjisë, urdhër nr 21 datë 25.01.2014 për miratimin e strukturës dhe të organikes së Institutit të Mjekësisë Ligjore, shpallim konkurs për:

A. Ekspert mjeko - ligjorë dhe kërkim shkencor, 4 vende
B. Ekspert mjeko - ligjorë pranë gjykatave të apelit, 9 vende
C. Ekspert Psikiatër ligjor, 2 vende

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Diplomë universitare të Fakultetit të Mjekësisë dhe specializimin pasuniversitar përkatës sipas sektorëve konkurrues.
- Curriculum Vitae (CV)
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Dëshmi gjyqësore
- Listën e notave të noterizuar

Shënim: Të gjithë kandidatët që do të marrin pjesë në konkurrim, do të konkurrojnë vetëm në një pozicion.

Kandidatët që do të garojnë për:


- Ekspert mjeko - ligjor dhe kërkim shkencor
- Ekspert psikiatër ligjor

Duhet të jenë njohës të anglishtes sepse konkursi do zhvillohet në anglisht.

Afati i fundit i dorëzimit të dokumentave është data **12 shkurt 2014**, ndërsa konkursi bëhet me datë **14 shkurt 2014**

Adresa: Rruga e Dibrës, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë. - Tel: 044200169/mobile: 0696206290

Në kryeqytet, sipas regjistrave janë 36 mijë deklarime Leje legalizimi vetëm për 10 % të objekteve 10 % e aplikuesve kanë paguar për truallin e zënë




Faksimile e lejes së legalizimit që prasin ta marrin 90% e aplikuesve në kryeqytet

Aplikimet

LORENC SHEHU
TIRANË

Procesi i aplikimit për legalizim të ndërtimeve informale si fenomen, startoi në janar të 2005, referuar ligjit të 2004, nëpërmjet njësisë të qeverisjes vendore. Këto të fundit, bazuar në ligj, organizuan mbledhjen e formulareve të vetëdeklarimit si dokument. Në vitin 2006, sic dihet, u miratua ligji i ri "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve/zonave informale". Kjo bëri të rihapej procesi i vetëdeklarimit si element identifikimi, për legalizim të këtyre ndërtimeve informale pranë njësisë të qeverisjes vendore. Kjo procedurë u krye në rrugë manuale dhe më pas u hodh në format dixhitale. Sipas Drejtores së Drejtorisë së ALUIZNI-it, Tirana 1, Orjeta Myzeqari- "Rezultoni, sipas regjistrave, të jenë bërë rreth 36.000 aplikime vetëm për territorin e Bashkisë Tiranë për kategorinë "objekte", dmth përjashtuar shtesat. Zonat me numrin më të madh të vetëdeklarimeve janë në njësinë bashkiakë nr. 11, njësinë bashkiakë nr. 6 si dhe njësinë nr. 2. Fakt është se një pjesë ndërtimeve pa leje, kanë mbetur të papërfshira në proces, për arsye të mungesës së informimit, të prezencës fizike të vetë poseduesit në Shqipëri dhe për shumë arsye të tjera objektive apo subjektive". Drejtorja e Aluiznit, Tirana 1, shton se- "Në kushte të mosvlerësimit nga njësitë e qeverisjes vendore, dhe në zbatim të nenit 10 të ligjit, për këtë kategori objektive, kompetenca për vijim të procedurës së legalizimit, ju dha Drejtorisë Qendrore të ALUIZNI-t. Kjo e fundit ngriti drejtoritë rajonale, në funksion të strukturës së re të miratuar. Së bashku me gjithë kompetencat, u trashëguua dhe u bë kalimi fizik i aplikimeve (vetëdeklarimeve). Ky ka qenë një moment i vështirë, probleme prej të cilit mbart edhe sot procesi. Kjo përthohet në mungesë koordinimi të materialit të përcjellë fizikisht krahasuar me listat e dërguara gjithashtu zyrtarisht prej njësisë. Dorëzimi i tyre, i kryer në mënyrë të pa-



Orjeta Myzeqari Drejtore e Drejtorisë së ALUIZNI-it, Tirana 1

kontrolluar në drejtorinë qendrore apo ato rajonale, ka sjellë mungesa materiali sot si në numër dosjesh ashtu edhe listash emërore të pasakta". Por pjesë integrale e këtij procesi, thotë Orjeta Myzeqari- "ka qenë edhe evidencimi i periudhës së ndërtimit informal, nëpërmjet fotografimit ajror, të njohur ndryshe edhe si Ortofoto. Qëllimi ishte pozicionimi i saktë i pasurisë mbi të cilën është

Statistikat

Që prej vitit 2005 janë pajisur me leje legalizimi rreth 10 përqind e subjekteve aplikues për territorin e Bashkisë Tiranë.

ndërtuar". Më tej Myzeqari thotë- "Që prej emërimit tim në detyrë, si drejtore e drej-

torisë së Aluiznit - "Tiranë 1", u bë i mundur listimi fizik i të gjithë praktikave të trashëguara në arkivën e drejtorisë. Kemi evidentuar raste të mungesës së dosjeve fizike, dhe kjo si rrjedhojë e transferimit dhe administrimit të pa përgjegjshëm nga minibashkitë dhe zyrat e Aluiznit, aktualisht kemi emra në regjistrat manuale të përcjellë nga njësitë vendore, për të cilat mungojnë dosjet fizike dhe anasjelltas".

U desh një punë e konsiderueshme, për të bërë të mundur evidentimin dhe regjistrimin e dosjeve fizike që u gjenden në institucion. Gjendja e trashëguar, ishte e vështirë përse i takon identifikimit të problematikave për secilin rast, pasi edhe dokumenta të cilat duhet të ishin pjesë përbërëse e dosjeve, kanë qenë menaxhuar në mënyrë të çrregullt. Gjatë vitit 2013, u hap një tjetër fushatë aplikimi për vetëdeklarimin e ndërtimeve informale, ku rezultoni të jenë depozituar rreth 900 aplikime. Megjithatë, edhe kjo ndërmarje tjetër, nuk rezultoni e plotë pasi nuk u publikua fort dhe nuk u bë mediatake, mënyrë kjo për të njohur popullsinë me këtë hap. Drejtorja e drejtorisë së ALUIZNI-it, Tirana 1, thotë se- "Që prej vitit 2005, kur

Verifikimi

Është tentuar të bëhej verifikimi i 60 objekteve në terren ku ka rezultuar se në 30-35 përqind të rasteve nuk gjenden personat në shtëpi

nisi procesi i vetëdeklarimit të ndërtimeve informale e deri më sot, janë pajisur me leje legalizimi rreth 10 përqind e subjekteve aplikues për territorin e Bashkisë Tiranë. Krahasuar me numrin e vetëdeklarimeve, kjo shiferë e përafërt, është tepër e ulët për periudhën 9 vjeçare". Nga i gjithë totali i objekteve të vetëdeklaruar, rreth 8 përqind e tyre, pas evidentimit në terren dhe kriterëve të parashikuara në aktet e legjisllacionit përkatës, konsi-

derohen si objekte të skuqifikueshme, kryesisht se bien ndesh me rrjetin infrastrukturor. Drejtorja Myzeqari thekson- "Nga numri total i aplikimeve, në rreth 10 përqind të rasteve, është bërë pagesa, detaj ky që ka lidhje me detyrimin financiar për cka ndërtimi pa leje i detyrohet pronarit të ligjshëm të truallit të zënë, qoftë ky i fundit privat apo shtet". Këto javë, është kryer një test me specialistët e përditësimit të truallit të zënë, qoftë ky i fundit privat apo shtet". Këto javë, është kryer një test me specialistët e përditësimit të truallit të zënë, qoftë ky i fundit privat apo shtet". Këto javë, është kryer një test me specialistët e përditësimit të truallit të zënë, qoftë ky i fundit privat apo shtet".

Legalizimi


TIRANË

Ngërçi me legalizimin e pronës, ka ndodhur për shkak të mosracionimit të institucioneve përgjegjëse. Por kjo situatë pritet të ndryshojë, duke pasur një koordinim mes tre institucioneve Ministria e Zhvillimit Urban, ALUIZNI dhe Agjencia e Kompensimit dhe Kthimit të Pronave. Ministria Gjermani, Kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame dhe drejtoresha e AKKP Sonila Qato vendosën që të kordinojnë punën e institucioneve të tyre, për procesin e legalizimit. "Proverbiale në këtë mungesë harmonizimi të punës mund të përmendet treshja legjendare ALUIZNI, ZRP dhe AKKP. Mosmarrëveshjet për vite me radhë të këtyre institucioneve kanë qenë tortura më e

madhe për çdo qytetarë që me heroizëm do ti shkonin deri në fund legalizimit të pronës së tyre. Nuk ka funksionuar raportimi me agjensinë kombëtare të planifikimit të territorit që edhe aty ku janë kryer legalizime ato kanë qenë të çrregullta dhe të paharmonizuar qoftë me planin e zhvillimit, qoftë me sistemin urban."-tha Kreu i ALUIZNI-it Artan Lame. Ministria e Zhvillimit Urban, bëri të ditur se paketa ligjore për legalizimet falas është në përfundim e sipër e për këtë do të angazhohen edhe njësitë bashkiakë. "Çështja e legalizimeve është një nga premtimet kryesore të qeverisë dhe kërkojmë

Procesi

Janë 50 mijë dosje e kërkesa që nuk kanë marrë përgjigje, ndërsa në 8 vite, nga 293 mijë kërkesa për legalizim janë bërë 22 mijë legalizime



Eglantina Gjermeni dhe Artan Lame

mbështetje edhe nga njësitë vendore. Jemi të angazhuar që të mos lejojmë ndërtime

pa leje, pasi procesi i legalizimeve nuk do kishte kuptim", është shprehur Gjermeni.

Paketa ligjore për legalizimet falas drejt përfundimit

Kreu i ALUIZNI-t Lame premtori se do të tejkalohet ngërçi

meni. Ndërsa Drejtoresha e AKKP-së, Qato bëri të ditur se insitucioni i saj po kryen skedimin e pronave. Drejtori i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive, Ilirjan Muho theksoi në fjalën e tij se brenda javës do të vihet në punë sistemi online i shkëmbimit të informacionit për statusin juridik të pronës, projekt ky që do të luajë një rol vendimtar për përsheptimin e procesit të legalizimit dhe uljen e korrupsionit. Ndërkohë që sipas statistikave në gjithë vendin janë 50 mijë dosje e kërkesa që nuk kanë marrë përgjigje. Ndërsa në 8 vite, nga 293 mijë kërkesa për legalizim janë bërë 22 mijë legalizime.

Hetimi

ELTON QYNO
TIRANE

Teksa dy bashkëpuntorët e drejtësisë Julian Sinanaj dhe Ndrëçim Gjokona, kanë mbyllur dëshminë e tyre para prokurorëve, drejtuesit e grupit hetimor kanë kryer gjatë kësaj kohe dhe një procedurë të rëndësishme, siç është ajo e sigurimit të dëshmitë në gjykatë. Kjo praktikë juridike e ndërmarrë nga ana e prokurorëve, jo vetëm që dy dëshmitë i siguron si provë kryesore dhe të rëndësishme të procesit hetimor dhe gjyqësor, por dhe nuk i le hapësira të arrestuarve Julian Sinanaj dhe Ndrëçim Gjokona, për të ndryshuar thënien gjatë kohëve në vijim. Nga ana tjetër, vetë gjykatat i konsideron prova bindëse deklaratat e dy bashkëpuntorëve të drejtësisë, dhe se mbi bazën e rrëfimeve të tyre dhe prova të tjera lidhëse, deklaracionet e akuzuarit e këtij procesi hetimor që sapo ka nisur nga ana e Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Burime pranë gazetës "Shqiptarja.com" thanë se sigurimi i dëshmitë të dy bashkëpuntorëve Sinanaj dhe Gjokona, është bërë nëpërmjet një kërkese në Gjykatën e Krimeve të Rënda, ku gjykatat pasi ka shqyrtuar materialin ka vendosur të pranojë kërkesën e prokurorëve, për të "blinduar" nga ana juridike dy dëshmitë e anëtarëve të grupit kriminal që kryent vrasje me pagesë.

DISPOZITA LIGJORE
Mundësia e kanosjes me jetë të Julian Sinanaj dhe bashkëpuntorit tjetër Ndrëçim Gjokona, dhe frika për një kthim prapa të dëshmitë së tyre të dhënë në Prokurorinë



TE ARRESTUAR

- Julian Sinanaj
- Ndrëçim Gjokona
- Marjon Mitro
- Ilir Karçini

Në kërkim

- Andon Mëshillaj
- Genis Mëshillaj

NË FOTO:
(Majtas) Julian Sinanaj
(djathtas) Ndrëçim Gjokona



Prokuroria siguron si prova deklaratimet e Gjokonës e Sinanaj

Blindohen në gjykatë dy dëshmitë e të penduarve

Ka rrezik kërcënimi, mund të ndryshojnë thëniet

e Krimeve të Rënda, ka shtyrë anëtarët e grupit hetimor të sigurojnë në gjykatë, provën kryesore të procesit hetimor. Në hetimet paraprake, deklaratimet e tyre lidhen dhe me shumë prova të tjera që janë gjetur në vendet ku janë bërë ekzekutimet. Por për të mos i dhënë ansjël mundësi të penduarve për ndryshimin e dëshmisë, prokurorët në bazë të nenit 316, pika B, të Kodit të Procedurës Penale, i janë drejtuar gjykatës, ku kanë kërkuar sigurimin e dy provave kryesore. Pikërisht në këtë nen thuhet se: "Gjatë hetimeve paraprake, prokurori mund të kërkojë nga gjykatat

Beci
Prokurori Eugen Beci, ka vendosur të bashkojë dy hetimet në një procedim të vetëm, pasi të dyja ngjarjet kanë lidhje me njëra-tjetrën.

që të procedohet me sigurimin e provës në rastin kur në marrjen e dëshmisë, ka arsye të bazuara për të menduar se personi mund të jetë objekt dhune,

kanosje ose premtimi për t'i dhënë para ose përfitime të tjera me qëllim që të mos bëjë dëshmi ose të bëjë dëshmi të gënjeshtrë". Pikërisht kjo dispozitë përmbush dhe situatën në të cilën ndodhen dy të penduarit e drejtësisë, dhe nisur nga kjo është kërkuar sigurimi i dëshmisë së tyre në gjykatë.

RRËFIMI I KRIMEVE

Gjokona dhe Sinanaj kanë pranuar të tregojnë gjithçka që dinë lidhur me veprimtarinë e grupit kriminal dhe vrasjet e kryera. I pari që ka folur për llogari të prokurorisë ka qënë shtetasi Ndrëçim Gjokona, i

cili nga frika e ekzekutimit prej Julian Sinanaj, pasi nuk i ishte bindur për të qënë bashkëpuntor në vrasjen e bosit të gazit Piro Bare, ka vendosur të tregojë gjithçka në polici, lidhur me planin e kurditur. Gjokona është marrë në mbrojtje nga autoritetet e rendit. Katër ditë pas kësaj dëshmie, është kapur në afërsi të gjykatës së Tiranës, vrasësi me pagesë i grupit Julian Sinanaj, i cili ska pranuar të flasë, por kur ka bërë ballafaqimin me Gjokonës, ka treguar edhe ai të gjithë planet e vrasjeve dhe krimet e kryera për llogari të kushërinjve Genis dhe Andon Mëshillaj.

DEKONSPIRIMI

Dosja hetohet tek Krimet e Rënda



— Oficerët e policisë së Tiranës që dekonspiruan arrestimin e dy kushërinjve Mëshillaj dhe nxorën të dhënat e bashkëpunorit të drejtësisë Julian Sinanaj, do hetohet nga Prokuroria e Krimeve të Rënda. Vendimi për hetimin e tyre është marrë disa ditë më parë, për shkak se çështjen kanë lidhje njëra me tjetrën. Momentalisht nga ana e prokurorisë është kërkuar informacion për thirrjet telefonike që kanë kryer disa oficerë, që kanë marrë pjesë në operacionin e policisë dhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Paralel me këtë hetim, veprime hetimore është duke kryer dhe Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, pranë ministrit së Brendshme, ku është ngarkuar me këtë detyrë ish-prokurori Zamir Shtylla.

Vendimi

TIRANE

Tre ditë para se policia të bënte publike megaoperacionin e shkatërrimit të bandës së tritolit, bashkëshortja e njërit prej kushërinjve Mëshillaj, të cilët arritën t'i shpëtonin arrestimit, nuk është paraqitur në punë. Bëhet fjalë për bashkëshorten e Genis Mëshillaj, e cila mban postin e nëndrejtoreshës së Institucionit të Shëndetit Publik në Vlorë. I kontaktuar me telefon drejtori i Shëndetit Publik në këtë qark, Tomor Caka, ka shpjeguar për "Shqiptarja.com" se Blerta Mëshillaj vartësja tij, njëherësh dhe punonjëse në organikën e Ministrisë së Shëndetësisë, prej disa ditësh nuk është paraqitur në punë. I pyetur mbi arsyet që ajo ka dhënë Caka ka pohuar se ajo




Gjykata e Krimeve të Rënda

ishite me leje të zakonshme, një pjesë e pakryer nga viti i kaluar. I pyetur për kohën se kur vartësja e tij ka filluar lejen e zakonshme drejtori Caka nuk ka dhënë një përgjigje duke u justifikuar me fjalinë se duhet të verifikonte letrat dhe kërkesat.

Prokuroria e Përgjithshme dhe Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm dyshojnë se ky operacion u dekonspirua duke ndihmuar largimin pa gjurmë të dy kushërinjve të cilët dyshohet se kanë vepruar si sekserë mes porositësve dhe Julian Sinanajt

10 mijë
Policia ka vënë në dispozicion 10 mijë euro për çdo informacion që do të mund të çojë në arrestimin e kushërinjve.



Genis Mëshillaj

2 oficerë
Sipas të dhënave, hetimi ka nisur sërisht nga Vlorë dhe në fokus janë dy oficerë policie, ku njëri prej tyre i përket policisë së



Andon Mëshillaj

Gruaja e Mëshillajt, punonjëse e ministrisë së Shëndetësisë Blerta Mëshillaj zëvendëse drejtoreshë në ISHP Vlorë

për vrasjet me pagesë. Tashmë ka nisur një procedim penal për "nxjerrje të sekretit hetimor", për funksionarët publikë, të cilët kanë publikuar informacione jozyrtare, lidhur me operacionin dhe hetimet, në kuadër të të cilave janë arrestuar disa persona

të dyshuar si të përfshirë në vepra të rënda penale, ndër të tjera edhe vrasje me pagesë. Sipas të dhënave, hetimi ka nisur sërisht nga Vlorë dhe në fokus janë dy oficerë policie, ku njëri prej tyre i përket policisë së Vlorës dhe tjetri policisë së

Tiranës. Edhe pse në sistemin TIMS dy të superkërkuarit nuk rezultojnë të kenë lëvizur jashtë vendit, porositësit e krimeve, sipas policisë mund të jenë të pajisur edhe me dokumente të tjera identifikimi ose mund të kenë lëvizur në rrugë tokësore.



Kanceri, të rrëzojmë mitet

NGA **ARJAN BREGU***

vijon nga faqja 1

...Dita Botërore e Kancerit është një mundësi për të ngritur zërin në emër të përmirësimit të njohurive të përgjithshme rreth kancerit, dhe për të hedhur poshtë idetë e gabuara, apo keqkuptimet në lidhje me sëmundjen.

FAKTE NGA BOTA

Kanceri është një nga shkaqet kryesore të vdekjes në botë, sidomos në vendet në zhvillim. Kanceri është një shkak kryesor i vdekjes në mbarë botën dhe llogariten rreth 7.6 milionë vdekje apo rreth 13% e të gjitha vdekjeve për vitin 2008. Në mbarë botën, llojet kryesore apo më të zakonshme të kancerit që vrasin njerëzit janë: kanceri i mushkërive, stomaku, mëlçisë, i zorrës së trashë, i gjirit dhe kanceri i qafës së mitrës. Llojet më të shpeshta të kancerit ndryshojnë midis burrave dhe grave. Në shumë vende në zhvillim, kanceri i qafës së mitrës është kanceri më i zakonshëm. Rreth 70% e të gjitha vdekjeve nga kanceri ndodhin në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Vdekjet nga kanceri në mbarë botën janë parashikuar të vazhdojnë të rriten në mbi 13.1 milionë në vitin 2030. Rreth

30% e vdekjeve nga kanceri ndodhin për shkak të rreziqeve kryesore të mënyrës së jetesës dhe sjelljes, si: mbipeshja e obeziteti, konsumimi i pakët i frutave e perimeve, mungesa e aktivitetit fizik, përdorimi i duhanit, si dhe përdorimi i tepruar i alkoolit. Përdorimi i duhanit është faktori më i rëndësishëm i rrezikut për shkakimin e kancerit; shkakton 22% të vdekjeve në tërësi nga kanceri dhe 71% të vdekjeve nga kanceri i mushkërive. Një e pesta e të gjithë kancerëve në mbarë botën janë të shkaktuara nga një infektion kronik, për shembull virusi i papillomës njerëzore (HPV) shkakton kancerin e qafës së mitrës dhe virusi i hepatitit B (HBV) shkakton kancerin e mëlçisë. Kanceri i shkaktuar nga infeksione virale të tilla si virusi i hepatitit B e C dhe virusi i papillomës njerëzore janë përgjegjës për deri në 20% të vdekjeve nga kanceri në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Rreth 70% e të gjitha vdekjeve nga kanceri në vitin 2008 kanë ndodhur në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Vdekjet nga kanceri në mbarë botën mendohet se do të vazhdojnë të rriten, dhe vlerësohet se në vitin 2030 do të ketë 13.1 milionë vdekje.

FAKTORËT RISK

Faktorët kryesorë të rrezikut që kontribuojnë në zhvillimin e kancerit në mbarë botën janë: Stili i jetesës: Përdorimi i duhanit, përdorimi i alkoolit, Dietat jo të shëndetshme, pasiviteti fizik, infeksionet kronike nga hepatiti B (HBV), hepatiti C (HCV virus) dhe disa lloje të Virusit të Papillomës Humane (HPV) janë faktorët kryesorë të rrezikut për kancerin në vendet me të ardhura ulëta dhe të mesme; Faktorët gjenetik të një personi janë faktorë rreziku; Disa agjentë të jashtëm, si karcinogjenët fizikë (rrezatimi

ultraviolet dhe jonizues); karcinogjenët kimikë (azbest, përbërësit e tymit të duhanit, aflatoxin dhe arseniku); Karcinogjenët biologjikë, si infeksionet nga viruset, bakteret ose parazitëve të caktuar; Moshimi është një tjetër faktor themelor për zhvillimin e kancerit. Incidenca e kancerit rritet me rritjen e moshës, probabiliteti për shkak të shtimit të rreziqeve për rritjen e kancerëve të caktuara që rriten me moshën.

FAKTE NGA VENDI YNË

Në vendin tonë, si në shumë vende të tjera të botës, kanceri vazhdon të jetë një problem i shëndetit publik. Kemi afërsisht 3500 raste të reja të kancerit çdo vit, sipas regjistratit të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", por duhet theksuar se në vendin tonë kanceri kapet në fazat e avancuara. Sipas INSTAT: Vdekjet nga tumoret zënë vendin e dytë në strukturën e vdekshmërisë së përgjithshme me 16%, dhe format më të shpeshta janë tumoret malinj të aparatit tretës, të frymëmarrjes dhe urogenitale. Gjithashtu 87.8% vdekjeve nga tumoret janë mbi moshën 50 vjeç. Tumoret malinj të aparatit tretës janë 2 herë më shumë të meshkujt se të femrat dhe zënë 32% të vdekshmërisë brenda grupit të tumoreve. Tumoret malinj të aparatit të frymëmarrjes janë 4 herë më shumë tek meshkujt se të femrat. Tumoret malinj të gjirit janë 4 herë më shumë të femrat se të meshkujt. Tumoret malinj të organeve urogenitale janë 1.6 herë më shumë të meshkujt se të femrat. Vdekjet nga tumoret në fshat zënë 46%.

TË RRËZOJMË MITET

Dita Botërore e Kancerit, për vitin 2014, do të fokusohet në objektivin e 5-të të Deklaratës Botërore të Kancerit: "Ulja e stigmës dhe rëzimi i miteve për kancer, me mesazh: "Të



Pamje nga brenda tek spitali i Onkologjikut

Rrëzojmë mitet".

Miti 1: "Ne nuk kemi nevojë të flasim për kancerin"

E vërteta: Të folurit hapur për kancerin mund të jetë një temë e vështirë për t'u trajtuar, por të folurit mund të përmirësojë rezultatet në nivel individual, në nivel komuniteti dhe të politikës.

Miti 2: "Nuk ka shenja ose simptoma të kancerit"

E vërteta: Për shumë lloje kanceresh ka shenja dhe simptoma paralajmëruese, dhe përfundim të zbulimit të hershëm janë të padiskutueshme.

Miti 3: "Unë nuk mund të bëj asgjë për kancerin"

E vërteta: Ka shumë që mund të bëhet në nivel individual, në nivel të komunitetit dhe të politikave me strategji të drejta; një e treta prej kancerëve më të zakonshme mund të parandalohen.

Miti 4: "Unë nuk kam të drejtën për kujdes ndaj kancerit"

E vërteta: Të gjithë njerëzit kanë të drejtë për akses, trajtime efektive të kancerit dhe shërbime në kushte të barabarta, pa vuarjtur si pasojë vështirësitë.

*) Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Shëndetit Publik

TURQI DHE MË SHUMË

STAMBOLL, ANKARA, IZMIR,
ANTALIA PLUS LONDËR,
KOPENHAGEN, DUBAI DHE
DESTINACIONE TË TJERA *

NGA

44.99

IPËRFSHIRË
TAKSAT
DHE PAGESA
TË TJERA

PEGASUS
AIRLINES

flypgs.com

MË ÇMIMET TONA MË TË ULËTA



*TË GJITHA FLUTURIME NËPËRMJET STAMBOLLIT

Mjekësia

SONILA ISAKU
TIRANE

Këshilli i profesorëve në fakultetin e Mjekësisë futet sërish në zgjedhje për kreun e ri. Ndonëse Ky proces duhet të kryejë në përfundim të mandatit njëvjeçar të Elsa Kones që u zgjodh për të drejtuar këshillin e profesorëve në muajin korrik të vitit të shkuar, pas ndërhyrjes së ministres Lindita Nikolla janë hapur sërish procedurat për zgjedhjen e drejtuesit të ri të këshillit. Sipas vendimit të marrë në mbledhjen e fundit u parashikua që data 5 shkurt të ishte afati i dorëzimit të dosjeve për mjekët të cilët do të kandidojnë për të qenë pjesë e zgjedhjeve të Këshillit të Profesorëve në Fakultetin e Mjekësisë. Deri në afatin zyrtar që përkonte me orën 14 të ditës së djeshme u dorëzuan dy dosje njëra nga Elsa Kone dhe tjetra nga Mihal Tase. Pas sekretimit dhe kryerjes së procedurave përkatëse Këshilli i Profesorëve ka përcaktuar që nesër (7 shkurt) të zhvillohen sërish votimi për të zgjedhur kreun e ri të profesorëve. “Pas përfundimit të afatit zyrtar vetëm dy kandidatë duket se kanë dorëzuar dosjet pranë komisionit të ngritur. Një prej tyre është Elsa Kone e cila u zgjodh para 6 muajsh si dhe Mihal Tase i cili ka bërë një fushatë gjatë këtyre ditëve” pohojnë burime zyrtare nga Fakulteti i Mjekësisë. I kontaktuar me telefon mjeku Tase ka konfirmuar se ka dorëzuar dosjen për të qenë një nga kandidatët e mundshëm për

Dy javë më parë ministria Nikolla anuloi vendimin e korrikut

Këshilli i Profesorëve nesër hyn në zgjedhje

Dy kandidatët zyrtarë, Mihal Tase dhe Elsa Kone

PROCEDURA

Zgjedhjet e kaluara u shoqëruan me debate

— Ngjehja e kreut të këtij këshilli, në korrik të vitit 2013, është shoqëruar me debate të forta mes shefave të QSUT-së, debat i cili është pasqyruar edhe në gazetën “Shqiptarja.com”. Kjo pasi një pjesë e profesorëve pretendojnë se nuk ishin numrat e duhura për të zgjedhur kreun e ri, dhe se dekanati ka manipuluar numrat e nevojshme për të konfirmuar legjitimitetin e kreut të këshillit të profesorëve. Sipas ligjit, kreu i këshillit të profesorëve të Fakultetit të Mjekësisë merr pjesë edhe në një bord të rëndësishëm: në bordin e ministrisë së Shëndetësisë dhe ka të drejtë vote edhe në përzgjedhjen e shefave të shërbimit të QSUT si dhe të miratimit të buxhetit.

Rëndësia

Kreu i këshillit të profesorëve të Fakultetit të Mjekësisë merr pjesë në bordin e ministrisë së Shëndetësisë dhe ka të drejtë vote edhe në përzgjedhjen e shefave të shërbimit të QSUT.

NË FOTO:
Fakulteti i Mjekësisë



të drejtuar Këshillin e Profesorëve. Këto zgjedhje erdhën për shkak se vetëm dy javë më parë Ministria e Arsimit, Lindita Nikolla anuloi vendimin e marrë në muajin korrik ku në krye të Këshillit të Profesorëve ishte vendosur Elsa Kone. Marrja e këtij vendimi nga ministria e arsimit ka ardhur pas një kërkesë të bërë nga 17 profesorë që kërkonin anulimin e kreut të këtij këshilli, pasi nuk është ndjekur procedura e duhur. Por duket se edhe zgjedhjet e reja do të përfshihen sërish

Mandati

Kreu i këshillit të profesorëve ka mandat një vjeçar dhe duhet të jetë një prej anëtarëve të këtij këshilli duke marrë ¼ e votave.

nga debatet pasi mjekët janë ndarë në dy grupe, dhe për pasojë parashikohen akuza për cilindo që do të votohet

edhe në këto zgjedhje. Sipas procedurës, kreu i këshillit të profesorëve ka mandat një vjeçar dhe duhet të jetë një prej anëtarëve të këtij këshilli. Pasi hapen zgjedhjet e reja, kandidatët shpallsin platformat, dhe fituesi duhet të marrë votat e 3/4 të profesorëve për t'u konfirmuar në krye të tij. Këshilli i profesorëve është një strukturë që në bazë të ligjit të arsimit të lartë, ekziston në çdo fakultet. Ai merret me anën akademike, kurrikulën, punën shkencore, etj, të fakultetit.

LAJME
shkurt

Kostot spitalore, turqit ofrojnë asistencë

Rajoni turk i Edemesë do të ofrojë ndihmesë në skemën e sigurimeve shëndetësore, trajnimin e personelit shëndetësor, si dhe për trajtimin e pacientëve. Kjo është pohuar nga drejtori turk i Fondit të Sigurimeve, Dr.Emrah Erten gjatë një takimi që ka pasur me homologun shqiptar Astrit Beci. “Ne ofrojmë ndihmesën tonë për skemën e sigurimeve shëndetësore, trajnimin e personelit shëndetësor si dhe për trajtimin e pacientëve përmes marrëveshjeve në rajonin tonë”, u shpreh në takim drejtori i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore të rajonit Ederne në Turqi, duke shprehur njëherësh interesimin për mënyrën e mbulimit shëndetësor në Shqipëri. Duke u ndalur tek paketat e shërbimeve që po hartohen aktualisht, Dr. Beci theksoi se ne po punojmë për të patur të gatshme në fillim të muajit prill, kostot e 5 paketave të shërbimit.



VKM, ulet marzhi i fitimit tek ilaçet

Geveria ka marrë vendimin që të ulë marzhin e fitimit për barnat, si ato në farmaci ashtu edhe në depot farmaceutike. Sipas vendimit të marrë dje, grosistët tashmë do të kenë një marzh fitimi prej 11 për qind në krahasim me 14 % që ishte deri më tani. Ky marzh do të shpërndahet me 3 % për shpërndarësit. Ndërkohë sa i përket çmimit maksimal të tregimit me pakicë të barnave ai caktohet të jetë deri në 25 për qind mbi çmimin e blerjes nga shpërndarësi farmaceutik. Deri më tani farmacistët kanë pasur një marzh fitimi prej 29 për qind. Duket se kjo ulje e marzhit të fitimit do të ndikojë në uljen e çmimit të barnave në vend. Një tjetër ndryshim ka të bëjë edhe me barnat e rimbursueshme për të cilat do të jetë Fondi i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor ai që do të vendosë se sa do të jetë ky marzh fitimi, ndërkohë që deri më sot ai ishte në nivelin 26 për qind.

Emrat

TIRANE

Emigrantët shqiptarë 32% me emra të huaj

Identiteti tjetër i përjashton nga pronësia

Ligji
Ekzistojnë hapësirat në ligj që këta shtetas të rifitojnë identitetin e tyre, por për çështjet e dokumentacionit në vendet fqinje ata refuzojnë ta bëjnë këtë.



i identiteteve nuk është një fenomen i ndërprerë. “Duke qenë se prej vitesh prindërit kanë braktisur emrat që kanë pasur në vendin tonë, edhe

për fëmijët e tyre vendosin emra të huazuar dhe që përshtaten në vendet në të cilët ata jetojnë”, shprehet për Shqiptarja.com një prej pu-

nonjëseve të gjendjes civile nr.2 në kryeqytet. Sipas saj, problematika më e madhe nga ky fenomen paraqitet në rastet e ndarjeve të pasurisë apo çështjeve të tjera të pronësisë, ku mbiemrat e familjarëve nuk korespondojnë duke i përjashtuar kategorikisht nga çdo e drejtë pronësie këta shtetas. “Edhe pse ne shpesh kërkojmë që me anë të hapësirave që egzistojnë në ligj, ku me anë të një vendimi gjyqësor këta shtetas mund të rifitojnë identitetin e tyre të mëparshëm për shkak të jetës dhe dokumentacioneve që emigrantët kanë krijuar në vendet që jetojnë refuzojnë të ndërmarrin këtë hap”, pohon zyrtarja e gjendjes civile.

CILËSIA

Malaj inspekton shkollat në Shkodër

— Zv/ministria e Arsimit dhe Sportit Nora Malaj, ka zhvilluar një inspektim në një pjesë të institucioneve arsimore në Shkodër. Gjatë takimit të zhvilluar në shkollën 9-vjeçare “Azem Hajdari”, Malaj veçoi projektet dhe prioritetet që ka dikasteri i Arsimit për vitin 2014 në lidhje me përdorimin e internetit nga të rinjtë. Ajo u bëri thirrje nxënësve që ta përdorin internetin me shumë kujdes dhe etike, duke e shfrytëzuar atë për zhvillimin e horizonteve të tyre.

Komisioni

SONILA ISAKU
TIRANE

Mjekët të ciët do të abuzojnë me komisionet mjeko-ligjore për dhënien e pagesës së paaftësisë do të kenë penalitete të rënda. Ky është propozimi i bërë nga Ministria e Mirëqenies Sociale i cili pritet të vihet në zbatim së bashku me reformën që po nis për pensionet. Ndërkohë propozimi paraprak është bërë ditën e djeshme në Komisionin Parlamentar të Shëndetësisë dhe Punës nga zv/ministria e Çështjeve Sociale e cila tha se po evidentohen rast pas rasti të gjitha abuzimet që janë bërë nga mjekët në ndryshëm. Në bashkëpunim dhe me Urdhrin e Mjekut do të diskutojmë tha ajo për të rritur masat penalizuese ndaj atyre që marrin rryshfet kundrejt vendimeve për dhënien e pensionit të invaliditetit. "Të rritet gjoha në masën 80% po mbi bazën e aktuale që ka mjeku dhe pezullimi i të drejtës së profesionit për një periudhë kohore, këtu jemi në diskutim për 3 apo për 5 vjet," tha Bardhylka Kospiri, zv/ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Abuzimet që janë bërë në komisionet mjeko-ligjore nga bluzat e bardha e dëshmon e dhe skema e fryrë e ndihmës ekonomike me njerëz që nuk plotësojnë asnjë kriter ligjor. Nga inspektimet e shërbimit social shtetëror, në shumë rrethe të vendit janë konstatuar dosje individësh për të cilat janë vendosur diagnoza nga më të ndryshmet nga ato kronike deri tek më të rëndat, ndërkohë që në realitet personat nuk vuajnë nga asnjë sëmundje. Por komisioni i Punës gjatë mbledhjes së djeshme ka diskutuar edhe në lidhje me reformën e pension-

Diskutohen ndryshimet mbi reformën e pensioneve

Mjekët abuzues me KEMP, 5 vjet pa licencë

Drafti i pensioneve gati në fund të muajit mars

Varësia
Instituti i Sigurimeve Shoqërore tashmë do të jetë në varësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe jo më në varësi të Ministrisë së Financave.



eve. Sipas Astrit Kukës, Drejtor i Pagesave të Kontributeve Shoqërore në Ministrinë e Mirëqenies Sociale në fund të marsit do të jetë gati projekti i reformës së pensioneve në Shqipëri, i pari që pas miratimit të ligjit pas viteve '90. Shtatë ligje do të rishikohen apo bëhen nga e para për të mos pasur mbivendosje të skemave të pagesave për kategoritë e pensionistëve, ndihmës sociale apo personave me aftësi të kufizuar. "Është parashikuar që skema të ketë dy shtylla kryesore. Të lidhe më mirë kontributet me përfitimet dhe së dyti asnjë shtetas shqiptar

të mos ngelet pa mbështetje financiare. Gjatë dy muajve të parë të mbarojë dokumenti i politikave të pensionit. Që të ndryshojë legjislacioni sepse flasim për sigurime shoqërore. Dhe brenda këtij ligji kemi 16

ndaj puna po përqendrohet në rregullimin e skemave për kontribuesit në vend. Një tjetër pikë e diskutimit për ndryshimet e ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" parashikohet edhe ndryshimin e emërimit të varësisë së ISSH-së, e cila nga Ministria Ekonomisë në vartësi të Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Por marrja e këtyre vendimeve për ish ministrin e ekonomisë Florin Mima skema e pensioneve është e dështuar që pa hyrë në fuqi pasi sipas tij është e njëjta skemë si në vitin 1993 dhe që rezultoi e pasuksesshme.

LIGJET

Shtatë ligje do të rishikohen apo bëhen nga e para për të mos pasur mbivendosje të skemave të pagesave për kategoritë e pensionistëve

miniskema të tjera, të cilat kanë ligje të veçanta," tha Astrit Kuka. Gjatë diskutimit është theksuar se ende nuk ka një marrëveshje për njohjen e kontributeve të emigrantëve,

DEBATI

Komisioni i shëndetësisë debate për tritolin

— Komisionit të Shëndetësisë u përshfi nga debati politik. Mungesa e përfaqësuesve të ministrisë së Brendshme, për sigurimet shëndetësore të uniformave blu, çoi në akuzën mes kryetares Albana Vokshi dhe deputetes Klodiana Spahiu. "Sot do të diskutonim edhe për sigurimet shëndetësore të uniformave blu por ministri përkatës nuk ka kohë të vijë në komision pasi puna e tij është vendosja e tritolit në pallate dhe makina" ka pohuar Vokshi. I menjëhershëm ka qenë reagimi i deputetes Spahiu. "Ai është duke kryer detyrën në terren, duke kapur bandat e tritolit dhe sigurisht që kjo punë është me e rëndësishme për të, për sigurinë e qytetarëve" ka pohuar Spahiu.

LAJME
shkurt

Ndotja, shpallet emergjencia

Shpallet emergjencia mjedisore në vend. Situata e rënduar nga mbetjet në shumë qytete të Shqipërisë ka bërë që ministria e mjedisit të ngrejë një task forcë për zgjidhjen e kësaj situatë në prag të sezonit turistik. "Nga portat kryesore të hyrjes në Shqipëri, në pikat e kalimit kufitar dhe deri qendër të kryeqytetit rrugët kryesore janë të mbushura me materiale të hedhura, papërgjegjësi. Mijëra goma të vjetra makinash, skelete automjesh, pjesë këmbimi, materiale të dëmtuara hidrosanitare. Shpallet gjendja emergjente mjedisore në vend, dhe rekomandohet ngritja e një Task Force për zgjidhjen sa më efikase të kësaj problematike shqetësuese," tha Oljana Ifti.



Urgjencat, mjekët trajnim në Turqi

Pesëmbëdhjetë mjekë shqiptarë të urgjencës u trajnuan në Turqi, në kuadrin e "Projektit të trajnimit të urgjencës në vendet ballkanike". Ky kurs trajnimi, i mbështetur financiarisht nga Ministria turke e Shëndetësisë, u fokusua në çështje të Shërbimit të urgjencës dhe të fatkeqësive natyrore. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë Ilir Beqaj, mjekët e grupit të parë të trajnimit në Turqi janë përzgjedhur nga i gjithë vendi, bazuar në sëmundshmërinë dhe shtrirjes së territorit, kriteret që do të mbahen parasysh edhe në përzgjedhjen e dy grupeve të tjera për trajnim. Ministri Beqaj tha se në këtë kuadër, Ministria e Shëndetësisë do të riaktivizojë kredinë prej 5 milion euro për qendrën e Traumës. Ndërkohë, Beqaj tha se trajnimi në Turqi përkon edhe me vizitën e ekipit shëndetësor turk të Edernesë në Shqipëri, me qëllim vlerësimin e mundësive të bashkëpunimit, dhe veçanërisht, trajnimin personelit mjekësor. Beqaj tha se po nisikohet fushatë e bashkëpunimit me këtë shtet mik, ndërkohë që fokusi do të jetë edhe tek shërbimi i Urgjencës.

Masat

TIRANE

Në pjesën më të madhe të institucioneve publike, rreth 180 mijë qytetarë të Shqipërisë me aftësi të kufizuara e kanë të pamundur të lëvizin, apo për të kryer shërbime të ndryshme publike. Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Erion Veliaj ka mbledhur Këshillin Ndërmimisterial, ku ka kërkuar zbatimin e rregullave të përshatshmërisë ndërtimore në institucionet publike dhe qendrore. "Të ndalohet menjëherë krijimi i barrierave të reja për mjediset urbane dhe investimet e reja publike. Të nisë puna për eliminimin e barrierave ekzistuese në institucionet publike, përmes vendosjes së aksesit. Ky prob-

PAK, Niko Peleshi: Projektet pa infrastrukturë do të bllokohen

Mungesa e rampave, dhjetëra fëmijë nuk shkojnë në shkollë



lem nuk është aspak i ri. Parvarësisht ligjeve të miratuara dhe konventave ndërkombëtare të ratifikuara, kemi rëndë në sindromën e miratimit dhe moszbatimit", deklaroi Veliaj. Zëvendëskryeministri Niko Peleshi tha se ligji ekziston, por në Shqipëri ai nuk zbatohet. "Si gjithmonë në Shqipëri legjislacioni nuk plotë. Mbese nuk është i plotë, por gjithsesi e imponon aksesin tek ndihmat të personave me aftësi të kufizuara.

Janë të gjitha institucionet që kanë në dorë ta detyrojnë zbatimin e ligjit", deklaroi Peleshi. Ministria e Turizmit dhe Planifikimit Urban, Eg-



PROJEKTET

Është një fond prej 100 milion dollarë këtë vit, që do të investohet në ndërtesa publike, në kopshte, çerdhe dhe shkolla

lantina Gjermani tha se asnjë projekt nuk do të miratohet pa plotësuar këtë kriter dhe do të punohet me shpejtësi, që këta persona t'i kenë sa

më shpejt të aksesueshme këto institucione. "Garantoj që në sekretariatit e ministrisë sonë një nga kriteret për projektet do të jetë patjetër aksesin për të gjithë, përfshirë atë për individët me aftësi të kufizuara. Më vjen mirë që ky kriter do të ketë zbatueshmëri. Brenda javës të gjitha ministritë do të kenë draftin", deklaroi Gjermani. Janë me dhjetëra fëmijë që nuk mund të frekuentojnë shkollën, apo me qindra persona të cilët nuk mund të marrin shërbime publike pranë qendrave shëndetësore, pasi nuk kanë ku të kalojnë.

LETRA EKSKLUZIVE



THEMELKO GOGO NUSHIT “Si luftuam me forcat e Ballit në Lushnje”

Letra e 28 gushtit 1943: ...na okupojnë shumë elementat e Ballit si Isa Manastirliu, Hamid Matjani, Halim Begeja, Xhep Picalliu dhe Alush Leshianaku federal në Elbasan, njashtu në Kavajë Qamil Xhani miku e shok i Mustafa Krujës dhe i fashizmit, nënprefekt në Kavajë dhe bashkëpunëtori i tij, Hamid Laçini...

ADMIRINA PEÇI
TIRANE

Nga letërkëmbimi midis Kristo Themelkos e Gogo Nushit, po në gusht të 1943, shkëpusim sot për lexuesit këtë letër të datës 28 gusht '43, ku bien në sy tre elementë: ardhja e misionit ushtarak anglez në Pezë dhe kërkesat e tyre me të cilat Themelko duket se nuk është dakord dhe thekson se duhet të tregohen elastik me ta, përpjekjet për tu organizuar e për të mbledhur materiale luftimi dhe ushqime, dhe ajo çka sundon, me tepër lufta e hapur ndaj forcave të Ballit Kombëtar, një luftë që në këtë periudhë është intensifikuar.

...na okupojnë shumë elementat e Ballit si Isa Manastirliu, Hamid Matjani, Halim Begeja, Xhep Picalliu dhe Alush Leshianaku federal në Elbasan, njashtu në Kavajë Qamil Xhani miku e shok i Mustafa Krujës

dhe i fashizmit, nënprefekt në Kavajë dhe bashkëpunëtori i tij, Hamid Laçini. Këta tregohen ballista dhe bashkëpunojnë me fashizmin për prishjen e partis etj. Shëtisin në Kavajë të armatosun, por megjithatë do bajmë dhe neve aksione...” i shkruan Themelko Gogo Nushit, ndërsa pak rreshta më poshtë i tregon prej një përpjekje me Xhafer Balin. “Me Ballin e kemi punën në çark dhe me Xhaf Balin ka plas luftë. Ai ka sulmue partizanët; shkaqet akoma në detaje s’i dimë por ai lufton neve, çetat tona e Darsis e Lushnjes, dhe batalioni i Lushnjes e kanë shpartallue, e kanë vu në ike mbas 6 orë lufte...”. Këto detaje të përshkuara nga Themelko në këtë letër, i japin një tjetër impuls tezës se në Shqipëri, në këtë periudhë (fundvera e '43-it dhe fillim i vjeshtës '43) pati luftë civile, tezë e artikulluar sidomos vitet e fundit nga një pjesë e historianëve. Kjo pasi në këtë periudhë nuk përmendet thujtase në asnjë prej letrave mes udhëheqësve komunistë të luftës, ndonjë përpjekje me armikun, por vetëm mes forcave kundëstare brenda vendit.

Dokumenti i plotë

I dashur shok Hysen

Mora letërën dhe mësova për çka më shkruaje, mora dhe 100 napolonat. Keni marrë vesh për nevojat tona sidomos për opingat, kush e di sa partizanë kanë mbet zbat e nuk munt të lëvizin.

Raportin për shtabin dhe qendrarin po e pregatis dhe me ardhjen e parë që do vinë korrierët do jua e dërgoj – kanë të drejtë ata që kërkojnë por puna e madhe që kam më pengon, i ngarkoj gjithë punë e prap ka punë të madhe e sidomos që kur kanë arth këta miqt na sjellin pengesa se duhet të preokupohesh me ta.

Kam marrë një letër nga Tarasi për ardhjen e tyne.

Këta kanë fjalë shumë, dhe premtive, por s’duhet ne të mvarim shpresën të këta, qëndrimi i jonë duhet të jetë elastik, pse dimë mirë qëllimin e tyre kryesor.

Pak fjalë që kam ba me ta thonë që neve do ndihmojmë gjithë ata që lëtojnë, dhe se në gjith vendet e Ballkanit kanë zbrit kësij miqsh dhe ndihmojnë luftën e popullit të robëruar, dhe forcat ushtarake të këtyne vendeve të Ballkanit janë vu në dispozicion të këtyne. Këjo fjalë anasjelltas vëhuni ju nën udhëheqjen tonë.

Unë ju përgjigja që lufta e popujve të robëruar që filloi dhe po vazhdon e që do vazhdojë, ka nxjerrë luftëtarë të çelnikosur, dhe drejtues të përsosur, njashtu kanë lind dhe komandat drejtuese të ushtrive N.Ç.I. të

popujve dhe aleatët munt të na ndihmojnë me ndonji material dhe po të duam mbasi neve luftojmë të njëjtin armik.

Më von po ju shkruajmë më gjat mbi këta, veçse kërkesat e tyne janë të mëdha, ushqime kërkojnë, plaçka për të ba gjellë, e tjera giana, ju i bleni dhe bani dhe listën sa kushtojnë, kërkojnë që të blenë dhe mushka. Pysni ju andej a munt të gjinden. M’i dërgoni ato çadrat që t’i japim dhe një atyne se kërkojnë të bajnë baraka.

Për ndihmat që do na vinë nga fondi N.Ç.I. e rregullojmë neve këtej dhe ju andej me korrierët. Do caktojme ekomatrin e shtabit – dhe at’i t’rregullojmë të gjitha gjanat që i takojnë ekonomisë.

Për specialistat që të qepin këpucët e rrobat na mungojnë e na mungojnë dhe veglat e këpucëtarëve.

Për aksione, ne kena ndërmend me ba por na okupojnë shumë elementat e Ballit si Isa Manastirliu, Hamid Matjani, Halim Begeja, Xhep Picalliu dhe Alush Leshianaku



Kërkesa

Anglezët duan të takojnë Mislimin personalisht

“Unë insistova që këtu ka shtab të qarkut dhe s’kemi punë individuale...”

bajmë dhe neve aksione. Na dërgoni plaçkat që t’i kompletujmë.

E mora vesh për Moravinë mbi qëndrimin e tij në kampo, dhe unë mejttoj masi s’ka shok më të përshtatshëm për zv.komisar politik të shtabit të qarkut. Çfar mejtton ju. Ka ba njifar autokritike se e shof dhe unë qëndrimin jo të mirë këtu për sa i përket mardhanjeve me shoqen, por faji qëndron te shoqja se asht sentimentale dhe me mbeturina borgjeze, dhe propozon që ta ndajmë dhe ajo të dërgohet në një vend që të punojë, por prap dhe ai ka punë të dobta. Mund të përmirësohet se e don partin dhe shokët.

Për Pandin, nuk ma ka tregue raportin, dhe ka ba gabim, dhe ja kam komunikue, por do bëjë autokritikë në celulë. Unë që propozova që të rrij afër shtabit. Jam bazue në këto gjana, 1) se ai njëf vendin dhe do t’i ndihmojë ekonomit për depot e 2) se njëf katundarë dhe merr informata prej tij dhe e 3) se duke qenë afër mua do përmirësohet dhe ma von do të na vlejë.

Për Xhemalin megjithse nuk e kam afër por shokët thonë se tregohet aktiv etj, të shohim edhe pak në ndonji aksion.

Përsa na shkroshit për paret që ka marrë kapiteni s’i ka tregu as dorëzë, por do t’ja thomi këtë gjana sa ta takojmë, se e kemi dërgue që të drejtojë veprimet në rast se pëlçet me katillat e Kavajës mbasi jemi fut me 100 vetë në katundet e tyne, tani më lajmëron një katundar por akoma s’e kemi vërtetuar se çetat tona kanë çarmatos elementat e Qamil Xhanit e të Hamid Laçinit të shofim.

Zenel Hekalli na ka marrë pare tue thanë se më ka Kamber Qafmolla paret e mija. Ja ka marrë hua dhe ai t’ja marrë Kamberit një xhandarit o kapitenit.

I shkruani për këtë gjana organizatës së Vlonës, se ka vajtur në Mallakastër.

Teshat e babës janë vonue shumë që kur ka qenë Doktorit këtu ia ka premte, dhe nuk kemi se si i themi, megjithse i kemi thanë se kanë punë mjaft.

Për aksionin e Kavajës harruam dhe nga ana tjetër nuk kishim shifër të saktë mbi gjanat që janë marrë.

Janë marrë afër 200 dele, 5 vija e këto materiale tjera, ja listën, njashu dhe 5 teneqe vaj guri që shokët pa pyt ja kanë shpërnda katundarëve.

Po e pyes çfar don të thuhaj s’e kuptoj, me fjalët, me organizue shtabin e batalionit. Unë ju kam raportue në letërën e parë si do i organizojmë këto forca që kemi.

Me Ballin e kemi punën në çark dhe me Xhaf Balin ka plas luftë. Ai ka sulmue partizanët; shkaqet akoma në detaje s’i dimë por ai lufton neve, çetat tona e Darsis e Lushnjes, dhe batalioni i Lushnjes e kanë shpartallue, e kanë vu në ikje mbas 6 orë lufte. Nuk dimë humbjet dhe ai ka ik dhe nuk dimë drejtimin nga ka shku.

Megjithse akoma Këshilla e Përgjithshme s’ka vendos qëndrim karshi Ballit, neve i demaskojmë për kërcënimet që bajnë në popull dhe për parullat e ndryshme që lëshoi, që dëmton luftën dhe bashkimin e popullit, dhe kur harrin në kullm dhe që na venë në pozitë të keqe dhe i bimë.

Presim nga K.N.Çl.P. e nga Partija

LISTA E PLAÇKAVE TË MARRA NË SHKOLLËN E KAVAJËS PËR NEVOJAT E LUFTËS NACIONAL ÇLIRIMTARE.

■ Çarçafë	166 cop.
■ Kuverta	77 "
■ Batanije	122 "
■ Përkavë	13 "
■ Jastëk me lesh	57 "
■ Këllëf jastëku	30 "
■ Pjata	126 "
■ Lugë	103 "
■ Lugë të mëdhaja	18 "
■ Thika	93 "
■ Pirunj	114 "
■ Tasa kauçuku	28 "
■ Tasa alumini	29 "
■ Kusija alumini	15 "
■ Kusija bakri	3 "
■ Kazana	4 "
■ Kazana alumini	1 "
■ Tepsija bakri	10 "
■ Tepsija alumini	10 "
■ Tava	3 "
■ Ibrigë	2 "
■ Sahatë	2 "
■ Fterë	2 "
■ Makinë mishi	3 "
■ Zdrug	1 "
■ Tela në torkë	1 "
■ Kanila	2 "
■ Tasa të mëdhenj bronzi	2 "
■ Trumpet	1 "
■ Pinca të mëdhaja	1 "
■ Radio	1 "
■ Shalë për kuaj	1 "
■ Makinë shkrimi	1 "
■ Makinë qepëse	1 "
■ Mushama	1 "
■ Kamineto	2 "

Kjo asht lista përveç deleve, viçave dhe vajgurit.

Çeta e Erzenit ka shpërnda të dhjetën e vjetme 35 qase populit në katundin Bërzhit Petrelës që ishte mbledhur nga dhjetari. 28.8.43 Shulja



Kemi dhe radjo po s’ka se kush mi merr lajmet. Kemi ba dhe një furrë për bukë.

Po t’mi dërgoni çadrat do bani mirë, se na duhen për shtabin.

P.S. asnjë plaçkë pa listë mos e dërgoni, dhe pa e shoqne korrierët deri te shtabi.

Kemi ba një porosi të madhe materiali nga këta miqt, po t’mi dërgojnë të gjitha këto ju dërgojmë dhe ju mjaft pushkë të vogla automatike për njësit e qytetit, të shofim.

Na premtojnë dhe pare me na dhanë, por ne kur të vij Mislimi do i themi jepjani shtabit madhor.

Mislimi s’gendet këtu, ka shku atje. Këta miqt kanë insistua që të takohen me Mislimin personalisht e atëhere do i porositim materialet, por dhe unë insistova që këtu ka shtab të qarkut dhe s’kemi punë individuale.

Na tha që janë dërgue me u takua me Mislimin nga shtabi i Kajros.

I thashë janë dërgue dhe prej Shtabit të Përgjithshëm të U.N.Çl. Shqiptare të këtëj shtabit.

Atëhere pranoi që të bisedojë me mua, i fola mjaft mirë që mos thotë t’ja fusim këtyne dhe as me e prish me ta.

Këtë letër po e shkruaj natën e me shpejtësi se korrieri nisat nesër e s’diam që të vonojë. Prandaj asht e ngatërruar pak dhe nuk di a do e kuptoni.


Dërgoni prap korrierat me plaçkat dhe të marrin raportin për K. Qendror.

Edhe ju kur bani letër e bani të ndarë punën e partis dhe të luftës N.Çl. se munt të ndodhi që letra të këndohet para shtabit.

Për atë aksionin e kombinuem me Dajtin e Çermenikën na dhatë përgjigje që me ba planet.

Tani të falë shoqnore Shulja 28.8.43

Doktorin s’e kemi pa, po të vij s’e lëshojmë se kemi ma tepër se njëzet të sëmurrë nga ethet.



Faksimile e letërës së 28 gushtit 1943 të cilin Kristo Themelko ja dërgon Gogo Nushit

federal në Elbasan, njashu në Kavajë Qamil Xhani miku e shok i Mustafa Krujës dhe i fazhizmit, nënprekft në Kavajë dhe bashkëpunëtori i tij, Hamid Laçini. Këta tregohen ballista dhe bashkëpunojnë me fazhizmin për prishjen e partis etj. Shëtisin në Kavajë të armatosur, por megjithatë do

NË FOTO:
Edi Rama, "Pikëllimi
i netëve kosovare"
1989. Vepra ruhet
në fondin e Galerisë
Kombëtare të Arteve



THOMA THOMAI: Rama bëri pikturën më të mirë me temën e Kosovës

Artistët rrëfejnë mbresat për pikturën "Pikëllimi i netëve kosovare". Çështja që trajton dhe personazhi që i dedikohet

Hashim Thaçi shared a link.
5 hours ago

Faleminderit Edi Rama për dhembshurinë dhe solidaritetin e dëshmuar në ato kohë aq të vështira nëpërmjet kësaj vepre mbresëlënëse. // HTH



Kryeministri

Kryeministri i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi i ka shprehur dhe faleminderimet homologut në Republikën e Shqipërisë "për dhembshurinë dhe solidaritetin e dëshmuar në ato kohë aq të vështira nëpërmjet kësaj vepre mbresëlënëse". Thaçi ka postuar një ditë më parë në Facebook mesazhin e tij, pasi është njohur me pikturën "Pikëllimi i netëve kosovare" të bërë nga Edi Rama më 1989 dhe të zbuluar për herë të parë nga Shqiptarja.com

DHURATA HAMZAI
TIRANE

Autori i pikturës "Pikëllimi i netëve kosovare", Edi Rama, ka pasur një këndvështrim të mprehtë për çështjen kosovare. Kështu shprehen ata që e komentojnë pas publikimit në "Shqiptarja.com" këtë pikturë. Ja si shprehet skulptori i njohur Thoma Thomai duke na treguar historinë e kësaj pikturë: "Tema që ka trajtuar Edi është shumë e vështirë, por ai me atë egon e tij të fortë, edhe i talentuar ishte, iu vu kësaj pune me ato mënyrat e mjetet e veta. E nisi këtë vepër me shumë guxim dhe frymëzim dhe ia arriti qëllimit që ajo të jetë me e vlerësuar. Arriti të prezantojë me sukses një strukturë kompozicionale të veçantë".

Thoma Thomai rrefen se të gjitha elementët e kësaj pikturë kanë qenë interesante:

"Mënyra sesi i ka harmonizuar figurat, ngjyrat, të gjitha janë bërë me përkushtim", thotë skulptori, duke shtuar se "Edi Rama ka qenë një piktor shumë i mirë dhe punonte me shumë këmbëngulje. Ç'të them unë më tepër për këtë vepër. Unë nuk kam qenë në komision kur u zgjodh vepra për fondin e Galerisë Kombëtare, por e mbaj mend që ishte një nga punët më të mira, më të vlerësuara dhe me një tematikë të vështirë. Kemi diskutuar shpesh për vlerat e saj. E bukur është kjo vepër edhe sot". Piktura "Pikëllimi i netëve kosovare" e vitit 1989 e Edi Ramës ka zgjuar reagime të ndryshme. Edhe pse kjo është një pikturë që tek kolegët, profesorët dhe miqtë më të ngushtë ka mbetur në kujtesë, duket habi që disa piktorë dhe skulptorë të atij brezi nuk kanë njohuri rreth kësaj pikturë, edhe pse ka qenë prej vitesh pjesë e koleksionit të Galerisë Kombëtare. "Pse ju befason kjo pikturë. Unë e kam thënë Edi Rama ka qenë një piktor shumë i mirë, ka qenë përfaqësues nga më të mirët e brezit tonë. Artisti vlerësohet me vepra, jo me opinione", thotë miku i tij L.L., piktor, i cili refuzon të shprehet me tej, sepse mendon se "tani që është kryeministër, do ma marrim vlerësimin e tij si servilizëm politik. Megjithatë ne i kemi pushtetet të ndara; unë në studion time dhe kryeministri në zyrën e tij, flasim njëherë tjetër për këtë vepër, vetëm jo sot që doli lajmi", thotë piktori duke ndërprerë rrëfimin. Nuk kam munguar komentet ku është vënë re se piktura e Edi Ramës është interesante dhe surprizuese, as ata që habiten kur vënë re një lidhje të fortë të piktorit me çështjen kosovare. Skulptori Thoma Thomai, e kujton shumë mirë këtë pikturë dhe befasinë që ka shkaktuar ajo në kohën kur u krijua, por edhe debatet. Edi Rama ka qenë vërtetë një piktor i talentuar. Dhe kjo ishte një pikturë shumë e mirë, thotë ai, -ndaj dhe pati diskutime për vlerat e saj. Mbjaj mend që titulli i parë ka qenë "Varrimi i Azem Galicës", por piktura është tepër simbolike, merr kuptimin që i kushtohet heroit, martirit të çështjes kosovare". Skulptori Thoma Thomai shprehet se piktura e Edi Ramës nuk ka si motiv varrimin e Jusuf Gërvallës, siç është shprehur Gjergj Marko, por të Azem Galicës. Ndërsa pas kësaj bisede ai shprehet se "pavarësisht se kujt i kushtohet, detajet piktorike janë gjithmonë në funksion të shprehjes, por duhet pasur kujdes me dedikimet se imazhi mund të keqinterpret-

tohet". Skulptori Pjerin Konikaj thotë se Edi Rama spikati me gjetjet e veçanta kompozicionale në vitet '80, kur ia kushtoi veprën çështjes kosovare. "Edi Rama ka intriguar me mënyrën sesi e paraqiti varrimin e Azem Galicës mbi një shpellë, pezull. Kjo gjë dilte jashtë skemave të realizmit socialist, por në vlerësimin që iu bë veprës ai pati fat, sepse në fundin e viteve '90 sapo kishte filluar të motivohej forma e e shprehjes. Megjithatë, Edi Rama e paraqiti me shumë guxim këtë vepër në trajtë kubiste dhe duke i bashkuar edhe motivin tepër kompleks të fatit të Kosovës, ia arriti të realizonte një nga pikturat më të më të mira"

KUJT I DEDIKOHET VEPIRA

Piktura aktualisht ruhet në fondin e Galerisë Kombëtare të Arteve me një titull më gjithëpërfshirës "Pikëllimi i netëve kosovare", siç janë edhe temat që prek autori. Perceptimet për pikturën moderne janë gjithmonë të ndryshme, ndërsa kritika ka mënyrën e saj origjinale të vështirimit. "Pikëllimi i netëve kosovare" ndryshe ka mbetur në kujtesën e njërit nga anëtarët e komisionit të ekspozitave që zhvilloheshin para viteve '90 në Galerinë Kombëtare, Gjergj Marko, i cili edhe pse i ka përpara syve që nga ajo kohë detajet dhe ngjyrat e veprës, duket u shprehur edhe se e ka pëlqyer jashtëzakonisht këtë vepër, ka bërë një lapsus dhe gabimisht është shprehur një ditë më parë për gazetën se piktura i është dedikuar varrimit të Jusuf Gërvallës. Pavarësisht se piktura me heronjtë dhe heroizmin që shfaqet në vepër është gjithëpërfshirëse, duhet saktësuar se në pikturën e Edi Ramës që trajton çështjen e luftës për pavarësinë e Kosovës, personazh është Azem Galica.

Por, në tërësi, po të vëresh detaje të tjera të tablosë është krijuar tashmë një kod simbolik që shpreh gjithë betejën historike të luftës së kosovareve për pavarësi.



Thoma Thomai



Pjerin Konikaj

PJERIN KOLNIKAJ

"Edi Rama ka intriguar me mënyrën sesi e paraqiti varrimin e Azem Galicës mbi një shpellë, pezull. Kjo gjë dilte jashtë skemave të realizmit socialist"



NË FOTO:
Edi Rama në
kohën kur
ka realizuar
veprën

» HOMAZHET

KUJTIMET E KOLEGËVE. Gjatë homazheve që u bënë dje nga ora 12.00 deri në orën 13.00 në UA, këngëtari i njohur Luan Zhegu ka rrëfyer për Shqiptarja.com kujtimet me mjeshttrin Madhi.



Homazhet për Artistin e Popullit Ibrahim Madhi që u zhvilluan dje në Universitetin e Arteve

LUAN ZHEGU:

Ju tregoj si këndohej nën tingujt e Ibrahim Madhit

E kam ndjekur hap pas hapi në koncertet e tij. Ai bënte edhe muzikë të lehtë. Bimi ishte universal

DHURATA HAMZAI
TIRANË

Është përcjellë dje për në banesën e fundit mjeshtri shqiptar i violinës, Ibrahim Madhi. Familjarë, miq, por edhe artistë nga fusha e artit dhe politikës ishin të pranishëm dje në Akademinë e Arteve për t'i bërë homazhet e fundit. "Talentë të tilla, në saj të kontributit dhe veprës së tyre mbeten pika të konsiderueshme referimi edhe për të ardhmen", u shpreh mes të tjerave kreu i Kuvendit, Ilir Meta, gjatë homazheve për ndër të Ibrahim Madhit dje në Akademinë e Arteve. Edhe presidenti Bujar Nishani ka shprehur ngushëllimet e tij për ndarjen nga jeta të violinistit. "Ibrahim Madhi, të cilin e kemi dëgjuar për vite e vite të tëra, sot, e mbylli violinën e tij dhe u nis drejt përjetësisë. Na la ndjenjën e pakufishme të respektit, të mirënjohjes dhe të vlerësimit për Artin dhe Artistin", thuhet në mesazhin e ngushëllimit të presidentit. "Ibrahim Madhi ishte shumë modest dhe i druhej bujës. Qëllimi i tij në jetë ishte muzika, koncertet dhe pedagogjia", shprehet këngëtari Françesk Radi, i cili një nga kujtimet e tij më të bukura ka atë të vitit 1994, kur shkuan në një koncert me Vaçe Zelenë në Zvicër. "Ishte koncerti i fundit ku Vaçja nuk u kthye më në atdhe dhe qëndroi atje, -kujton Radi, -por unë nuk do ta harroj mënyrën sesi Madhi na mboldhi dhe si organizoi gjithçka në mënyrë aq perfekte dhe që na emocionoi të gjithëve". Violinist i njohur, Ibrahim Madhi, ndërroi jetë në moshën 68-vjeçare, të martën rreth orës 14:00, pas një sëmundjeje të



Këngëtari Luan Zhegu

rëndë. Gjatë homazheve që u bënë dje nga ora 12.00 deri në orën 13.00 në UA, këngëtari i njohur Luan Zhegu ka rrëfyer për Shqiptarja.com kujtimet me mjeshttrin Madhi.

Zoti Zhegu, ju kenë qenë miq të skenës, si është ndër këngëtari Luan Zhegu duke kënduar në shoqërinë e tingujve të violinës së Ibrahim Madhit?

-Ibrahimi, mbi të gjitha, ishte një muzikant shumë i madh. Me të drejtë ai mban titullin Artist i Popullit. Ai vërtetë i takonte popullit me mprehësinë që kishte. Por edhe si mik, si njeri ishte i mrekullueshëm dhe si familjar. Unë kam përshlyer shumë të mira për Bimin (kështu u thërrisnin shkurt të gjithë miqtë e tij) se unë e kam njohur shumë më afër. Kemi ndenjur bashkë. Kemi bërë turne jashtë shtetit bashkë. E çmoj për ngrohtësinë e tingullit mbi të gjitha. Bimi ishte një koncert-maester i mrekullueshëm, por violina e tij këndonte. Me ikjen e tij arti shqiptar humbi një nga personalitetet e artit,

por ai ka lënë vepra shumë dhe do të jetë gjithmonë mes nesh dhe ne do ta kujtojmë gjithmonë, gjithmonë, gjithmonë Bimin e madh, siç kishte edhe mbiemrin e tij.

Ai ka pasur edhe aftësinë e riinterpretimit të kompozitorëve shqiptarë që nuk janë më...

-E vërtetë është kjo. Dhe veçantia e tij ishte se ato pjesë vinin akoma më të reja edhe më emocionuese nga telat e violinës së tij. Ky ishte Bimi.

Zoti Zhegu, së bashku ju kenë kaluar një jetë në skenë dhe kenë jashtë koncerte brenda dhe jashtë vendit, cilat janë kujtimet tuaja?

-Nuk ka qenë vetëm kjo lidhja jonë, por edhe të qenit në sallë kur ai jepte koncerte. Unë i kam parë të gjitha koncertet e Bimit, sidomos

Lamtumirë profesor!

Violinist i tingullit të bukur, elegant e shprehës

Unda nga jeta Ibrahim Madhi, Mjeshtri i padiskuteshëm i violinës, mësuesi, pedagogu, drejtuesi, kritik, udhëheqësi shpirtëror, që është një ndër mbajtësit më të denjë të titullit "Artist i Popullit". Për të gjithë ne që patëm fatin të përfitojmë nga talenti, eksperiencia dhe gjënaliteti i tij, kjo është një humbje e madhe, por mendoj se humbja i kapërcen kujtije kombëtare. Ai ishte ndër pionierët e themelimit të shkollës shqiptare të muzikës, duke dhënë një kontribut të çmuar në formatimin e shkollës shqiptare të interpretimit. Që në moshë të re dallohet për prirje të veçanta splistike, por kur në vitin 1962, në moshën 16-vjeçare, interpretoi plot siguri e autoritet Koncertin e Mendelsonit për Violinën e Orkestrës, i shoqëruar nga orkestra Sinfonike e RTV shqiptar, nën drejtimin e dirigjentit Mustafa Krantja, skena do të ishte sfida e tij më e madhe. Në vijim, shumë vepra të tjera kapitale të repertorit violinistik botëror e kombëtare do të merrnin jetë nga talenti i Mjeshtrit Madhi, në bashkëpunimet e tij me Orkestrat Sinfonike të RTV-shqiptar, TOB, ILA, AKV, Orkestra e Harqeve e ILA, të cilën e themeloi dhe e drejtoi vetë me shumë sukses deri pak vite më parë. Në të gjitha rastet ai është njohur si violinist i tingullit të bukur, elegant e shprehës, duke treguar në çdo rast individualitetin e tij të spikatur artistik në skenat e Shqipërisë, Kosovës, Turqisë, Rumanisë, Kinës, Greqisë, Italisë,



Ibrahim Madhi

Francës, Gjermanisë, Zvicrës, etj, duke marrë vlerësimet maksimale nga kritika e duartrokitje të gjata nga publiku. Emri i tij lidhet jo vetëm me të qenit solist brilant e i kompletuar, por dhe me themelimin e drejtimin e përkryer të grupeve të para të ansambleve të dhomës, ku mund të veçojmë Orkestrën e Harqeve të Universitetit të Arteve, Trion, etj, duke ndihmuar në krijimin e traditës së lojës në këto ansamble që u bënë shumë të njohura e të dashura për publikun e gjërë. Me përgjegjësi dhe cilësi të lartë artistike ka interpretuar pothuajse të gjithë repertorin violinistik shqiptar, duke realizuar premierën në shumicën e rasteve. Ai ka shumë orë incizime e regjistrime në studio apo direkt nga sallat e koncerteve me Radio-Tiranën, TVSH, Radio Prishtinën, Radion e Pekinit (Kinë), Radion e Grazit (Austri) etj, të cilat vazhdojnë të jenë në transmetim. Edhe në fushën e drejtimin dhe administrimit, kontributi i tij mbetet i padiskuteshëm. Si drejtues i I. L. Arteve (1977-1981), dhe dekan i Fakultetit të Muzikës (2003-2007), ai ka lënë gjurmë të pashlyeshme në konsolidimin e shkollës shqiptare të artit dhe në frymën bashkëkohore të saj. Por mbi të gjitha tek Profesor Bimi do të mbetet i paharrueshëm aspekti Human, njeriu që njihje vetëm tolerancën, respektin për talentin, urrejtjen, bashkëpunimin, paqen, mirësinë e forcën e karakterit. Lamtumirë Profesor!

Prof. Dr. Isak Shehu, prof. Ass. Kastriot Tusha

ato koncerte për violinë e orkestrës, në ekzekutimin e të cilave Bimi ishte një mrekulli. E kam ndjekur hap pas hapi në koncertet e tij. Madje ai bënte edhe muzikë të lehtë. Ibrahim Madhi ishte një universal. Mjeshtri ka qenë

njeriu që diti të bënte muzikë, diti të mësonte instrumentistët e rinj dhe diti të bëjë edhe politikë. Ishte një njeri i gjithanshëm, sepse kishte një talent që i bënte për vete studentët dhe kolegët.

Teatri i Komedisë, letër Metës:

Të mos votohet ndryshimi i emrit

Teatri Kombëtar i Komedisë kundërshton emrin e ri të vendosur për këtë institucion, Teatri Eksperimental, "Kujtim Spahivogli", nga ana e Ministrisë së Kulturës. Në një letër drejtuar Kryetarit të Kuvendit, Ilir Meta, bordi i teatrit i kërkoi Kuvendit të mos e votojë ndryshimin e emrit. "Projektligji nuk është bërë publik, por në dy prononcimet e vetme për këtë çështje, ministrja Kumbo e pretenduar në konferencën për shtyp të datës 15 janar se kjo është kërkesë e komunitetit të artistëve" pa sqaruar se cilët janë këta artistë, kur dhe si janë shprehur", thuhet në letrën e bërë publike



të TKK-së. "Eksperimentet i bëjnë natyrshëm individët gjatë punës krijuese, jo sepse ministria u ka ofruar një teatër për të bërë eksperimente. Gjithsesi, sallat ku jepen shfaqje me "muzikë, kërcim dhe komedi" nuk quhen teatro, por kabare, estrada ose varietë", thuhet ndër të tjera në këtë peticion, ku kërkohet që ndryshimet e tjera në ligjin "Për Artin dhe Kulturën" të bëhen në konsultime me komunitetin e artistëve. Ndryshimi i emrit të TKK-së, në Teatrin Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli", u miratua nga qeveria më 15 janar dhe tashmë pret miratimin nga Kuvendi".

SATIRË
POLITIKE

NGA ARBEN DUKA



Policia ka arritur tek nota dhjetë...

Them se policia, po bën mrekullira, dhe s'mund t'ja kursejmë, fjalët më të mira.

Gjithë frytet e mundit, këto ditë ka vjelë, ndaj sot ka në rrugë, më pak kriminelë.

Ne që e mbështesim, jemi optimistë, sot kemi në rrugë, më pak tritolistë.

Them se policia, është në kohë të artit, se zbulimi i krimt, ka nivel të lartë.

Këto rezultate, kush këtu s'i pa, ose është një qorr, o një maskara.

Ka bërë policia, mrekulli vërtetë, sa nuk bënë të tjerët, jo pak-po tet' vjetë.

Fundin ka arritur, palo opozita, gjersa policinë, shan e shan përdita.

Policia shpifjet, nuk i meriton, se me jetë të saja, jetën tonë e mbron.

Po kjo polici, o shokë të qymyrit, s'është e Edi Ramës, dhe as e Tahirit.

Tani që kanë ikur, Salinjte e rrëmetit, është dhe do të jetë, një aset i shtetit.

S'është e Edi Ramës, prapë po e them unë, por ai arriti, që ta vëjë në punë.

Makinën e prishur, që na le-Sali, Rama ka paisur, me motorr të ri.

Dhe pse ikanakët, nuk lënë gjë pa bisht, ky motorr i ri, punon mrekullisht.

Motorri i ri, punon mrekullisht, dhe nuk po përdoret, sot politikisht.

Ndaj politikisht, kur ajo sulmohet, them se me zëdhënës, s'ka nevojë të mbrohet.

S'ka pse të harxhojë, kohën kot me fjalë, sepse policia, mot asnjë s'është palë.

Veç për katër muaj, kjo gjë është arritur, gjë që ikanakët, nuk e kishin pritur!

Askush nga lyrashët, këtë nuk e priste, të bëhej kaq shpejt, kaq profesioniste.

Tani shpifarakëve, krejt u doli boja, dhe kuptohet helmi, që nxjerrin nga goja.

Të zejë qymyri, shoh pas çdo fytyre, sepse do zbulohen, dhe bëmat e tyre.

Ata që si mortja, këtej u qëruan, polici të fortë, këtu kurrë s'duan.

S'duan që Rilindjes, t'i dalin premtimet, se sovrani di, t'i bëjë krahasimet.

S'besoj se këtu, ka ndonjë idiot, që s'bën diferencën, me djë e me sot.

Ikanakët lanë, mbrapa shumë hendeqe, po sot krimi është, në ditë shumë të keqe.

Ky është për të gjithë, një lajm i gëzuar, vetëm ikanakët, jan' të shqetësuar!

Jan' të shqetësuar, duken që së largu, se e kanë kuptuar, që po mblidhet laku.

Gjithë njerzit e ndershëm, këtu duan paqe, po jo qelbësirat, që s'kanë cipë në faqe.

Kush shan policinë, kërkon veç rrënimin, dhe "vullnetarisht", bëhet palë me krimin.

Them "vullnetarisht", si pak me lezet, se ata kanë qënë, këtu krimi vetë.

Jo më kot po lozin, këtë marrëzi, sot që policia, u bë polici.

Unë hallin e tyre, e kuptoj vërtet, palo shtet' i tyre, sot po bëhet shtet.

Tani po dëgjohej, një tjetër muzikë, horri dhe i ligu, shtetin e kanë frikë.

Baladë

Statuja..

*Në dyluftim jam me kujtesën,
mbuluar plot me male hiri,
po ti më ngrihesh mbi harresën,
si një statujë e lartë floriri.*

*E cila zëmër njerëzore,
do kish guxim për të harruar,
këtë statujë madhështore,
që kohën krejt e ka sfiduar.*

*Tani pak uje kam në qiell,
dhe sytë më ngrinë në perëndim,
statuja jote ndrin si diell,
në sfond i tretur shpirti im!*



Gjergj ZHEJIT

Po ti më ishe më i shtrënjti, nga miqtë në këtë jetë, më kot nuk kishe emër shënjti, se shënjti ishe vërtetë.

Qe ikja jote-çast i kobshëm, rufe më ra në kokë, o vaj e det sa të përkohshëm, ne jemi përmbi tokë.

Askush që rron me njerëzinë, s'shpëtoi nga kjo shpatë, ç'e do pastaj përjetësinë, në pluhur e në natë!

Dhe të mos isha hiç sëmure, i fortë të isha hekur, tek ty nuk do të vija kurrë, s'të shihja dot të vdekur!

Për mua ende nuk ke ikur, kjo shpresë gjallë më mban, kandilen tënde krejt të fikur, nuk e kam parë-o xhan!..

Ishe si deti-krejt i qetë, plot thellësira brënda, më fal-o mik-më fal vërtetë, që pranë nuk t'u gjënda!

Kur mëmë-zeza m'u ka tretur, kaq dhimbje po kam ndjerë, do jepja gjithë ç'më ka mbetur, ta shihja dhe njëherë.

Po dhe për ty-o mik do falja, dhe gjënë më të shtrënjtë, një ditë të vetme të të ngjallja, se ishe kaq i shënjtë!

Do fluturonim në Odrë, ku shpirti im u dergj, në ato vise prej magjie, tek kisha-në Shën Gjergj!

NGA ARBEN DUKA

VIP-a dhe RRIPA

» INTERVISTA

LAJMI për binjakët ka qenë habi, impakti i parë ka qenë totalisht gojëhapur. Pastaj u ambientova me idenë dhe tani jam super e lumtur që ishin dy

XHULIA KARAVELLA
TIRANE

Balerina Olta Ahmetaj, përmes një interviste për rubrikën "Pink Report", rrëfen të rejtat më të fundit sa i përket fushës profesionale, por edhe bekimit me dy binjakë, të cilët duket se ja kanë ndryshuar jetën. Në këtë rrëfim, Olta nuk lë pa përmendur as marrëdhënien e saj me Fabianin e grupit "Produkt 28", e cila ka arritur në nivele të tjera.

Diçka rreth palestrës si po ecën, cilat janë disiplinat, grupmoshat që e preferojnë?

Për momentin kemi vetëm grupmoshën e fëmijëve akoma nuk kemi filluar me të rriturit duke qenë që unë kam dy të vegjël në shtëpi, të cilët ende nuk po më lënë të përkushtohem tërësisht punës. Për këtë arsye kemi filluar me fëmijët, janë disiplina të ndryshme janë modernet janë latinet është klasikja, modernia dhe baleti klasik duke qenë edhe si disiplina por edhe si ndarje grupmoshash, megjithatë avash avash edhe palestra jonë do të nisi të hapet për të gjitha grupmoshat

Baleti është një tjetër formë që tashmë është vënë në lëvizje. Është shtuar interesimi ndaj baletit?

Në fakt, do të thoja se është shtuar goxha interesimi i të rinjve pasi i fëmijëve ka qenë gjithmonë, duke shfaqur gjithnjë interes dhe sidomos prej vajzave të vogla. Ndërkohë për të rinjtë nuk ka qenë e njëjta gjë por mund të them se ky interesim është shtuar goxha duke specifikuar kërcimet latine dhe zumba.

Po përsa i përket jetës tuaj private, e cila nuk është lënë asnjëherë janë vëmendjes së mediave. Në fakt ka pak kohë që jeni bërë nënë me dy binjakë, do të doja të dija diçka më shumë rreth lindjes së tyre përkujdesjes në këto muajt e parë?

Muajt e parë kanë qenë totalisht mbyllur në shtëpi. Gjatë gjithë kohës jam kujdesur për ta dhe normalisht e gjithë vëmendja ka qenë tek ata.

Si ishte impakti i parë kur mësuat se ishin dy në fakt dhe jo një?

Të them të drejtën ka qenë habi, impakti i parë ka qenë totalisht gojëhapur. Pastaj u ambientova me idenë dhe tani jam super e lumtur që ishin dy.

Gjithashtu dimë që Fabi ka asistuar gjatë lindjes së tyre, si u gjend në këtë situatë?

Nuk e di, kishte me shumë qef të asistonte pasi mendonte se do e trembe pamje do e trembe situata. Por, ai e ka përjetuar jashtëzakonisht mirë dhe mund të them se ishte pozitive që ishte në lindje, pasi mua më erdhi një



Olta Ahmetaj dhe Fabi me binjakët e tyre

OLTA AHMETAJ: Jeta ime mes binjakëve dhe baletit Një rrëfim për karrierën dhe skenën

pikë që në fakt nuk dëgjoja më askënd përveç Fabit, dhe shqyr që ishte i pranishëm.

Cili është më i lëvizur nga të dy, cili ju shkakton pak më shumë "probleme"?

Ai që është më i vogël (qesh). Ai që ka lindur 10 minuta më vonë dhe që ka qenë më i vogël në peshë që në shtatzëni dhe është akoma më i vogël në peshë.

Keni njëfarë ndasie të tipit në fakt që i madhi është i babet, diçka e tillë apo i keni njëllor?

Në paraqitje le të themi që i madhi është i mamit dhe i vogli është i babet, por është e vështirë pasi përditë të dy marrin tipare të ndryshme të njëri-tjetrit.

Ndërkohë, është komentuar edhe fakti që ndoshta do të ndani të dy edhe në aspektin profesional?

Ta shohim mbase nuk bëhet asnjëherë as balerin as këngëtar. (qesh)

Do ja të ndalesha pak tek projektet e të dyve, pasi punoni në të njëjtin ambient, në të njëjtin media. Si ka qenë kjo pjesa kur të dy punoni në të njëjtin media por në sektor të ndryshëm?



Olta Ahmetaj dhe Fabi

Na ka munguar mjaft të punojmë sërisht bashkë. Zakonisht të gjithë na thonë që nuk punohet në të njëjtin vend. Nuk kuptohesh po të jesh në të njëjtin shtëpi dhe në të njëjtin vend pune. Për ne nuk ka qenë kështu, madje e kemi ndërjer mungesën e njëri-tjetrit, sidomos këto 5 ose 6 muajt e fundit ku unë kam qenë në shtëpi dhe Fabi ka qenë në punë. I kemi munguar mjaft njëri-tjetrit.

Që në fillim të lidhjes e

deri tani keni hasur probleme pasi të dy jeni artistë dhe kuptohet që është një profesion disi më ndryshe nga të tjerët. Si e keni menaxhuar?

Jo në fakt sepse edhe menaxhimi i lidhjes ka qenë njëllor si menaxhimi i punës. Na ka ardhur natyrshëm e gjitha.

Që do të thotë se është më mirë të jenë në të njëjtin profesion?

Për mua është vërtetë shumë mirë. (qesh)

Diçka sa i përket projekteve tuaja të reja?

Kemi shumë projekt-ide. Ideja është se kur do të realizohen por, nuk jemi duke u shpejtuar për të realizuar ato projekte që edhe unë e kam lënë përgjysëm. Gjithashtu edhe Fabi do t'i futet disa projekteve të reja dhe të vjetra që ai ka lënë përgjysëm.

Po sa i përket "Produkt 28" do të kemi ndonjë rikthim të bendit pasi ka mjaft kohë që nuk publikojnë diçka të re?

Ajo është një pjesë që i takon "Produkt 28", pasi nuk di të ta them nëse do të publikojnë një këngë apo një album të ri. Është pjesë që ju takon atyre.

Kalendari Kulturor

Teatri Kombëtar

- Teatri Kombëtar shfaq sot komedinë "Kur njihesh në internet" të regjisorit Kiço Londo. Komedia sjell kaosin që ndodh në jetën e Xhon Smith, kur bigamia e tij është duke u zbuluar nga dy familjet e tij.
- Interpretojn; Roland Saro, Orsi Vangjeli, Ermira Hysaj, Esela Pysqyli,
- Alesia Xhemalaj, Ergys Çekrezi dhe aktorit që i rikthehet komedisë, Xhevahir Zeneli.
- Në datat 6, 7, 8, 9, 13, 14, 15, 16 shkurt.

Galeria Kombëtare

- Me datë 6 Shkurt 2014, ora 18.00, Galeria Kombëtare e Arteve ka kënaqësinë të hapë për publikun ekspozitën me pllakate të artistit hungarez Péter Pócs. Ekspozita tregon një përzgjedhje të veprave të këtij artisti duke u fokusuar kryesisht tek pllakati kulturor por që përfshin edhe disa kulme personale të artistit në pllakatin politik.



Programi i filmave në IMPERIAL

Salla 1

- "Labor Day" 2D/ 20:30 / çmimi 500 leke
- "Believe Justin Bieber" 2D/ 13:00 / 18:00 / çmimi 500 leke
- "Paranormal Activity: The Marked Ones" 2D/ 15:30 / çmimi 500 leke
- "Jack Ryan" 2D/ 22:30 / çmimi 500 leke
- "Smurfs 2" 3D/ 10:30 / çmimi 500 leke

Salla 2

- "Saving Mr.Banks" 2/ 13:30 / 18:30 / 21:00 / çmimi 500 leke
- "Frozen" 2D/ 11:00 / 16:00 / çmimi 500 leke



- "Labor Day" 2D/ 21:00 / çmimi 500 leke
- "Believe Justin Bieber" 2D/ 13:00 / 19:00 / çmimi 500 leke
- "Paranormal Activity: The Marked Ones" 2D/ 17:00 / çmimi 500 leke
- "Smurfs 2" 3D/ 15:00 / çmimi 500 leke
- "Frozen" 3D/ 10:30 / çmimi 500 leke

Kampionati

DYLBER BALLA
TIRANE

Hasan Lika ndez derbin FSHF pezullon Jorgjin

Trajneri i të kuqve: Me Tiranën dua vetëm fitore

Në prag të ndeshjes më të rëndësishme të kampionatit shqiptar të futbollit mes Partizanit dhe Tiranës, trajneri i të kuqve, Hasan Lika është shfaqur para medieve me mjaft optimizëm për të fituar sfidën, që sipas tij nuk duhet të humbet, jo thjeshtë se është ndeshja e radhës, por sepse është derbi i kryeqytetit. "Të premtën luajmë derbin tradicional të kryeqytetit ndaj Tiranës, një ndeshje e cila është tepër e rëndësishme për vetë emocionet që ajo mbart ndër vite por edhe rivalitetin e madh që ka shoqëruar të dyja ekipet. Për ne është një ndeshje e radhës edhe pse jemi të vetëdijshëm që kjo sfidë duhet të fitohet, për të qenë gjithnjë e më pranë objektivave tona. Përgjatë gjithë javës jemi përgatitur për të përballuar pozitivisht këtë ballafaqim si fizikisht edhe psikologjikisht. Disa prej lojtarëve të afruar së fundmi ndoshta ende nuk e dinë rëndësinë e derbit, por besojmë se në fushë ata do të japin më të mirën për ti dhuruar tifozëve tanë fitoren" deklaroi Lika. Trajneri i të kuqve duke mos dhënë më shumë hollësi mbi formacionin që do të zbrësë në fushë nesër në orën 18:00 deklaroi se gjendja e futbollistëve është e mirë.

SKANDALI NË KAVAJË, DËNOHEN GJYQTARËT
Burime pranë FSHF bëjnë të ditur se katërshtja e arbitrave të cilët gjykanin ndeshjen Besa - Laçi me kryesor Enea Jorgjin janë pezulluar pa afat. Shkak i pezullimit nga



(Në mes) Gjyqtari Enea Jorgji

ushtrimi i detyrës është gafa që bëri Jorgji në anulimin e 11-metërshit që u shndërrua në gol nga Sefa. Enea Jorgji mban edhe stemën e FIFA-s, por gafa në Kavajë ishte mjaft e rëndë, duke çuar FSHF të marrë një vendim ekstrem për elbasanasin. Për dënimin të Jorgjit FSHF është në hall edhe për gjendjen e një arbitri për sfidën Tirana-Partizani, pasi pjesa tjetër e arbitrave janë të kontestuar nga dy palët. Ndërkohë që Komisioni i Disiplinës ka zbardhur edhe vendimet e mbledhjes së radhës: Zyrtari

LEGJIONARI
Frankfurt-Kapllani nisin bisedimet për kontratën
— **Duket se problemet mes Frankfurt dhe Edmond Kapllanit kanë kaluar. Sulmuesi durrsak dhe klubi gjerman, ku bën pjesë dhe lojtari tjetër i kombëtares Odise Roshi, kanë nisur dje bisedimet për kontratën e re. Sot janë bërë vetëm hapat e parë, dhe takimi**

tjetër është lënë për në fund të marsit ose në fillim të prillit, megjithatë duket se bisedimet po ecin në rrugën e duhur. Kapllani dhe klubi patën mosmarrëveshje me tyre pak muaj më parë, kur shqiptari theu rregullat dhe gjuajti penalltinë gjatë ndeshjes.

Partizani
Disa prej lojtarëve të afruar së fundmi ndoshta ende nuk e dinë rëndësinë e derbit, por besojmë se në fushë ata do të japin më të mirën për ti dhuruar tifozëve tanë fitoren' tha Lika.

Skandali
Shkak i pezullimit nga ushtrimi i detyrës është gafa që bëri Jorgji në anulimin e 11-metërshit që u shndërrua në gol nga Sefa. Enea Jorgji mban edhe stemën e FIFA-s.

LAJME shkurt

Roma fiton me Napolin 3-2
Roma ka mposhtur Napolin në sfidën e parë gjysmëfinale të Kupës së Italisë që u zhvillua në 'Stadio Olimpico' me rezultatin 3-2. Totti dërgoi një top bukur te Gervinho, i cili zhbloko rezultatin në 13'. Kevin Strootman me një goditje nga distanca e dyfishoi epërsinë. Morgan De Sanctis shënoi autogol në të 47' në fillim të pjesës së dytë, ndërsa Dries Mertens e barazoi rezultatin në të 70'. Golin e fitores për Romën e shënoi Gervinho në të 88'.



Kupa, Reali i tregon vendin Atletikos
Reali i Madridit është me një këmbë në finalen e Kupës së Mbretit, pasi arriti që të siguronte një fitore të thellë përballë Atletikos me rezultatin e thellë 3-0 në stadiumin 'Santiago Bernabeu'. Pjesa e parë u mbyll me golin e Pepe-s, ndërsa e dyta u thellua me golin e Jese, i cili nuk e pati të vështirë të dërgonte topin në rrjetë, pas një pasimi të bukur e të saktë të Di Marias. Golat tërhoqën Atletikon në mbrojtje në pafuqi për të shënuar, teksa humbet edhe psikologjikisht dhe pëson edhe golin e tretë, këtë herë autogol nga Miranda pas gjuajtjes së Di Marias.

FSHF i "falet" Maltës Sadiku realizon dopietë

Sfida e 5 Marsit për të 'mbërthyer' Xhakën

Miqësoret
TIRANE

Ndërsa Kombëtarja ka zgjedhur për të zhvilluar ndeshjen miqësore përfaqësuesen e Maltës. Ndeshja mes dy ekipeve do të luhet në kuadër të datës së lirë të FIFA-s më 5 mars 2014. Ky është takimi i parë për këtë vit për trajnerin De Biasi dhe kandidatet e mundshëm

të Kombëtares shqiptare. Kuqezinjtë janë të interesuar që në këtë takim të paraqesin vlerat e tyre më të mira përballë sportdashësve të tyre. Herën e fundit kuqezinjtë me Maltën janë takuan në kuadrin e fushatës eliminatore në grupet Botërorit 2010, teksa Shqipëria drejtohej nga holandezi Ari Han. Në "Qemal Stafa", Shqipëria fitoi me rezultatin 3-0. Shqipëria mban vendin e 56-të me 571 pikë, ndërsa

Malta në vendin e 130-të, me 198 pikë. Ndeshja pritet që të zhvillohet në stadiumin e qytetit të Durrësit, 'Niko Dovana', ndërsa trajneri italian De Biasi do t'u japë një mundësi futbollistëve të rinj për të treguar vlerat e tyre. Trajneri De Biasi akoma nuk e ka shpallur listën për ndeshjen me Maltën, por priten risi përsa i përket futbollistëve të rinj që janë afruar. Sytë e të gjithëve do të jenë të Taulnat Xhaka, vëllai i Granit

DESHTIMI FSHF dështoi për të gjetur një kundërshtar më të fortë, duke iu falur Maltës



Futbollistët e kombëtares duke festuar

Xhakës që zgjodhi Zvicrën për të vazhduar karrierën e tij. FSHF dështoi për të gjetur një kundërshtar më të fortë, duke iu falur Maltës, teksa miqësorja duket se po zhvillohet vetëm për Taulant Xhakën. Ndërsa Armando Sadiku duket se është gati për sfidën e re me Zyrich, edhe pse në ndeshjen e parë zyrtar

bomberi shqiptar e nisi nga stoli. Në miqësoren e djeshme që skuadra e tij luajti kundër ekipit të kategorisë së dytë Schaffhausen, e përfunduar 2-2, Sadiku luajti nga minuta e parë dhe shënoi një dopietë, duke hapur serinë e golave në minutën e 26 dhe dyfishoi në të 50. Megjithatë Zyrich nuk e ruajti dot avantazhin.

KUKELI:
'Dëmtimi më kushtoi vendin në Kombëtare'

— Burim Kuklesi në një intervistë për mediat zvicerane shprehet se dëmtimi që e mbajti një vit larg fushave e penalizoi edhe në Kombëtare. "Pak përpara dëmtimit, po kaloja një moment të mirë. Kisha luajtur ndeshje e mia të para me Kombëtares shqiptare, si dhe kisha mbushur gjysmë viti të Zyrin. Kështu që objektivat që lashë në mes ishte të fitoja vendin në kombëtare dhe të bëja një sezon të mirë të Zyrin" deklaroi ai. Meshuori pritet të thërritet nga De Biasi.

LAJME
nga bota

Kosova: 15 vjet burg për ata që luftojnë në Siri

Qeveria e Kosovës miratoi një projektligj, përmes së cilit bashkimi në konfliktet e armatosura jashtë territorit të vendit konsiderohet veçer penale. Sipas tij, kjo veçer penale është e dënueshme deri në 15 vite burg. Kështu njoftoi ministria e Integritit, Vlora Çitaku në rrjetin social Facebook. Ka qenë ministri Bajram Rexhepi, i cili në mbledhjen e Qeverisë ka paraqitur projektligjin që ka të bëjë me pjesëmarrjen e shtetasve të Kosovës në luftërat e huaja. Disa qytetarë të Kosovës janë raportuar të vrarë në luftën në Siri. Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim Tërnava, u ka bërë thirrje të rinjve kosovarë që të mos shkojnë në Siri, ku lufta nuk ka të bëjë me fenë, pasi, tha Tërnava, aty po zhvillohet luftë ndër-vëllezërore.

Arrestohet djali i Ibrahim Rugovës për trafik

EULEX ka arrestuar dje djalin e ish-presidentit kosovar Ukë Rugova, si dhe disa persona të tjerë të dyshuar për krim të organizuar. Të arrestuarit janë: Ukë Rugova, Izet Beqiri, Florjan Petani (qytetar nga Shqipëria, punonjës në konsullatën italiane në Prishtinë), Edison Idrizaj, Fitim Beqiri, Visar Beqiri, Azad Beqiraj, Hamza Beqiri. Jozyrtarisht u tha se Ukë Rugova është arrestuar me dyshimin se është përfshirë në shitje vizash. Fjala është për shitjen e 100 vizave italiane, në bashkëpunim me një punonjës të ambasadës italiane. Një vizë është shitur për 3.500 euro, ndërsa në këtë trafik janë të përfshirë persona nga komuna të ndryshme. Një njësi speciale e EULEX-it, herët në mëngjesin e së mërkurës, ka hyrë në shtëpinë e ish-Presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova.

Turqia i dorëzon Greqisë bankierin në kërkim

Në Athinë ka mbërritur dje ish-presidenti i 'Helenik Post Bank', Angelos Filippidis, një prej personave më të kërkuar nga drejtësia greke, si kreu i superskandalit të kredive të kësaj banke. Ndonëse nuk ka detaje lidhur me dërgimin e tij në Greqi, burime policore thanë se prej ditësh autoritetet greke dhe ato turke kishin nisur bisedime për shkëmbimin e tij me agjentë të shërbimeve turke, të arrestuar në Greqi nën akuzë spiunazhi. Filippidis konsiderohet si ndër njerëzit më të afërt të ish-kryeministrit grek Kostas Karamanlis. Bashkë me 15 drejtorë dhe konsulentë të 'Helenik Post Bank', akuzohet se u ka dhënë kredi pa kriter biznesmenëve, duke i shkakuar dëm gati 500 milionë euro bankës.

Abonohu!

[SHQIPTARJA.com]
origjina e lajmit...

Për t'u abonuar ju lutemi kontaktoni me:

Posta Shqiptare
042 375 598
abonime@postashqiptare.al

Agjencia e Abonimit të Shtypit
066 20 47 825
arben.trenova@yahoo.com

Adrion ltd
04 22 40 018
069 40 36 824
sales@adrionltd.com

[SHQIPTARJA.com]
në versionin dixhital

SHKARKON FALAS APP
tek website:
www.SHQIPTARJA.com
nga Apple Store

[SH].COM
origjina e lajmit...

Duke blerë abonimin ju mund të lexoni gazetën që nga ora 2:00 e mëngjesit dhe paguani më pak

MUND TË LEXOINI GAZETËN NË:

në kompjuter
në adresën: www.shqiptarja.com

iphone

ipad

Alba Malltezi - Drejtore e Përgjithshme e Free and Fair Media Group ; Genc Kondi - Kryeredaktor
Admirina Peçi Kryeredaktore e "Rilindasi" ; Politikë: Jakinarena ; Aktualitet: Elton Qyno ; Sociale: Sonila Isaku ; Ekonomik: Lorenc Shehu, Ilir Sinanaj ;
Kulturë: Dhurata Hamzai ; Sport: Dylber Balla ; Design: Altin Aliaj, Genti Manelli ; Website: Suela Gera ; Shpërndarja: Spiro Meshini tel: +35569608847

Departamenti i Marketingut:
Vera Perleka
Tel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Redaksia: Rruga: "Derwish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: KLASS shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë